

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6146  
E premte, 23 tetor 2020  
çmimi 0.40 €

Veseli në Mitrovicë:  
Pasuritë e Kosovës  
askush nuk mund  
t'i vendosë në pazar FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KOSOVËS VAZHDON T'I BËHET E PADREJTË ME PROCESIN  
E LIBERALIZIMIT TË VIZAVE FAQE 4-5

## LIBERALIZIMI I VIZAVE PRITET TË SHTYHET PËR VITIN TJETËR

Njohësit e integritimeve evropiane kanë paralajmëruar se vendimmarrja për liberalizim të vizave, sipas të gjitha gjasave, do të shtyhet për vitin tjetër. Demush Shasha dhe Arbëresha Loxha-Stublla kanë bërë me dije për "Epokën e re" se është shumë vështirë të mendohet se këtë vit BE-ja mund të marrë ndonjë vendim për këtë proces. Sipas tyre, BE-ja as në raportin e fundit për Kosovën nuk jep ndonjë afat për këtë proces. Ata kanë vlerësuar se institucionet e Kosovës duhet të punojnë më shumë me vendet anëtare të BE-së të cilat janë skeptike për liberalizimin e vizave për Kosovën



## PAS 'AVULLIMIT' TË 2 MILIONË EUROVE, NJË MUAJ PARABURGIM PËR PUNËTORIN E THESARIT

Gjykata Themelore në Prishtinë i ka caktuar të enjten masën e paraburgimit prej një muaji punëtorit të Thesarit të Kosovës për rastin e transferimit të dy milionë eurove nga ky institucion shtetëror në një kompani private. Gjykata Themelore ka njoftuar se mori vendim ta dërgojë në paraburgim L. G., e frikësuar se i njëjti mund të arratiset apo edhe ta pengojë rrjedhën e procedurës penale, duke ndikuar në dëshmitarë apo në bashkëpunësues të tjerë FAQE 7



1 500 SPECIALIZANTË  
I SHTOHEN SISTEMIT  
SHËNDËTËSOR KËTË VIT FAQE 7



### AKTUALE



NË SAMITIN E SOFJES DO TË  
KEMI NJË PLAN VEPRIMI PËR  
TREGUN E PËRBASHKËT  
RAJONAL F. 2

MINISTRJA HARADINAJ-STUBLLA  
PARALAJMËRON VIZITË NË IZRAEL F. 5

QEVERIA DO T'I NDAJË EDHE  
2 MILIONË EURO PËR  
KOMUNITETET JOSHUMICË F. 6

### EKONOMI

MTI-ja LANSOI DATABAZËN  
PËR TREGTINË NË SHËRBIME F. 8

KEDS ACADEMY VIII HAP  
DYERT PËR STUDENTËT DHE  
NXËNËSIT F. 8



### SPORT

GASHI: SERIA POZITIVE E  
BALLKANIT NUK NDALET F. 14



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## BE-ja nuk e di kur mund të vazhdojë dialogu Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 22 TETOR - Bashkimi Evropian ende nuk e di se kur do të vazhdohen takimet në mes të delegacioneve të Kosovës dhe Serbisë në kuadër të dialogut që zhvillohet në Bruksel. I pyetur se kur mund të ndodhë takimi i radhës, pasi tash e disa javë nuk ka pasur takime, zëdhënësi i BE-së për Politikë të Jashtme, Peter Stano, ka thënë se "puna e të dërguarit të posaçëm (për dialogun), Miroslav Lajçak dhe ekipit të tij po vazhdon dhe është një punë e ngjeshur. Sapo të kemi ndonjë datë për të shpallur për takimet e radhës ne do ta bëjmë këtë. Zëdhënësi i BE-së nuk ka dashur të komentojë as takimin e fundit të Këshillit të Sigurimit

të Kombeve të Bashkuara në të cilin u diskutua rreth dialogut dhe situatës në Kosovë. Ai nuk u përgjigj as në pyetjen se a ka qenë i ftuar Miroslav Lajçak për të folur në atë takim apo jo. "Për aranzhime rreth takimeve, për diskutimet, duhet ta adresoni pyetjen në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për hollësi. Ne nuk kishin paralajmëruar asgjë dhe nuk mund të komentojmë nga ana jonë", ka thënë ky zëdhënësi.

Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë kishte rifilluar më 16 korrik dhe ishin zhvilluar disa takime si në nivel të lartë në mes të kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq,



ashtu edhe mes delegacioneve në nivel ekspertësh. Por, për më shumë se një muaj nuk ka pasur takime të reja. Një prej shkaqeve ishte refuzimi i Kosovës për të biseduar rreth asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë dhe insistimi i Serbisë që të bisedohet për këtë temë si prioritet.

Për të përgatitur takime të reja, në Kosovë dhe Serbi para një jave ka qëndruar i dërguari i posaçëm i BE-së për dialog dhe çështje të tjera të rajonit, Miroslav Lajçak. Por deklarata e tij se mund të ndryshohet Kushtetuta e Kosovës kishte shkaktuar shumë reagime në Kosovë. (rel)

## Në Samitin e Sofjes do të kemi një plan veprimi për tregun e përbashkët rajonal



PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - "Disa vlerësime tregojnë se integrimi ekonomik rajonal në Ballkanin Perëndimor mund të gjenerojë deri në 2,5 për qind rritje të PBB-së nëse niveli i integritit arrin nivelin e EFTA dhe nëse arrin nivelin e integritit që ka BE-ja, mund të gjenerojë 6.7 për qind të rritjes së PBB-së. Prandaj, jam e lumtur që në Samitin e Sofjes më 10 nëntor do të kemi një plan veprimi, udhërrëfyes shumë të mirë drejt tregut të përbashkët rajonal në Ballkanin Perëndimor", ka thënë Majlinda Bregu, sekretare e përgjithshme e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), në panelin "Dalja e Ballkanit Perëndimor nga Çrregullimi i Ri" Western Balkans, Emerging from the New Disorder", në edicionin e 10-të, të Forumit të Sigurisë, i cili është mbajtur online të enjten në Beograd. Bregu ka theksuar se tregu i përbashkët rajonal do të vulosë këtë herë jo vetëm

domosdoshmërinë e bashkëpunimit rajonal, por edhe një nevojë më të fortë për integrim më të thellë ekonomik të rajonit, duke e harmonizuar atë me rregullat e BE-së për tregun e përbashkët. "Do ta ndjekë ngushtësisht qasjen e katër lirive që drejtojnë tregun e përbashkët të BE-së, ndërtuar në bazë të sukseseve të planit të parë të veprimit të zonës ekonomike rajonale por, gjithashtu, do të përqendrohet në investimet digjitale, inovacionin, zinxhirët e prodhimit të BE-së etj. Ne presim që tregu i përbashkët rajonal të miratohet nga liderët në Sofje", ka thënë ajo.

Sekretarja e përgjithshme e RCC-së, Majlinda Bregu, ishte pjesë e panelit të fokusuar në çështjet kryesore të sigurisë së "ekuilibrit joliberal" në rajon, të ardhmen e procesit të zgjerimit të BE-së dhe mundësitë e bashkëpunimit rajonal në kohën e Covid-19.

## Veseli në Mitrovicë: Pasuritë e Kosovës askush nuk mund t'i vendosë në Pazar

MITROVICË, 22 TETOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka vizituar të enjten qytetin e Mitrovicës. Veseli ka bërë thirrje edhe një herë që Ujmani dhe Trepça të mos diskutohen si pjesë e dialogut me Serbinë. "Në

bashkëbisedimin që pata me qytetarë të Mitrovicës, vihej re qartë shqetësimi i tyre për paqartësinë dhe mungesën e transparencës që po tregon qeveria aktuale për sa i përket çështjes së dialogut. I sigurova që askush nuk do të guxojë ta prekë integritetin territorial

dhe sovranitetin e shtetit tonë të pavarur dhe se as Ujmanin e as pasuritë e tjera të Kosovës nuk do të mund kush që t'i vendosë në pazar. Ato janë e do të mbeten pasuri të Kosovës dhe do të vihen vetëm në shërbim të qytetarëve të saj", ka thënë Veseli pas kësaj vizite.



# Pas 'avullimit' të 2 milionë eurove, një muaj paraburgim për punëtorin e Thesarit

Gjykata Themelore në Prishtinë i ka caktuar të enjten masën e paraburgimit prej një muaji punëtorit të Thesarit të Kosovës për rastin e transferimit të dy milionë eurove nga ky institucion shtetëror në një kompani private. Gjykata Themelore ka njoftuar se mori vendim ta dërgojë në paraburgim L. G., e frikësuar se i njëjti mund të arratiset apo edhe ta pengojë rrjedhën e procedurës penale, duke ndikuar në dëshmitarë apo në bashkëpjesëmarrës të tjerë



**EPOKA  
ERE** **Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 22 TETOR** - Gjykata Themelore në Prishtinë i ka caktuar masën e paraburgimit prej një muaji punëtorit të Thesarit të Kosovës për rastin e transferimit të dy milionë eurove nga ky institucion shtetëror në një kompani private. Policia e Kosovës ka njoftuar të mërkurën se e ka arrestuar të dyshuarin L. G., kurse dy persona të tjerë, që janë pronarë të kompanisë private ku u transferuan paratë, gjenden në arrati. Siç njofton gjykata, i pandehuri me iniciale L. G. dyshohet për veprat penale "keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar". Gjykata Themelore ka njoftuar se mori vendim ta dërgojë në paraburgim L. G., e frikësuar se i njëjti mund të arratiset apo edhe ta pengojë rrjedhën e procedurës penale, duke ndikuar në dëshmitarë apo në bashkëpjesëmarrës të tjerë. "I pandehuri L. G. dyshohet se më 9 tetor 2020, në cilësinë e personit zyrtar, ka keqpërdorur detyrën zyrtare duke realizuar transaksione në vlerë prej 2,077,995.90 eurosh në adresë të një kompanie, me të cilat veprimet i ka shkaktuar dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në shumën prej 2,077,995.90 eurosh dhe me këtë dyshohet se ka kryer veprën penale Keqpërdorim i Pozitës apo Autoritetit Zyrtar nga neni 414 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës", ka njoftuar Gjykata Themelore e Prishtinës. I arrestuari L. G., punëtor i Thesarit të Kosovës, dyshohet se ka bërë transferimin e mbi 2 milionë eurove përmes katër transaksioneve të ndryshme, në llogari të kompanisë LDA Group Shpk (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar), me bazë në Llapushnik, fshat në Komunën e Glllogocit, 30 kilometra larg Prishtinës. Avoakti i L. G., Veton Rrecaj, ka thënë se Prokuroria nuk paraqiti "asnjë provë konkrete relevante e cila do ta mbështeste një pretendim të

tillë, mirëpo kërkesa ishte tërësisht e përgjithësuar, e supozuar dhe në asnjë rast nuk pati mundësi ta argumentojë të njëjtën". Ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, gjatë një raportimi të enjten para Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ka thënë se transferimi i mbi dy milionë eurove nga Thesari i Kosovës në llogarinë e një kompanie private është realizuar përmes një krimi kibernetik. "Pas tre minutave që jam informuar, menjëherë e kemi denoncuar rastin në Polici. Ky është krim ekonomik i realizuar përmes një krimi të thellë kibernetik, ku janë bërë qasje të paautorizuara, janë tejkuluar autorizimet ligjore, është bërë keqpërdorim i detyrës zyrtare dhe janë thyer fjalëkalimet", ka deklaruar Bajrami. Sipas saj, transaksioni prej mbi 2 milionë eurove është transaksion bankar dhe ka gjurmë për gjithçka. Për këtë transaksion, ka shtuar Bajrami, nuk është

kërkuar as nënshkrimi i saj dhe as nënshkrimi i drejtorit të Thesarit të Kosovës. "Krimi është i gjurmueshëm dhe me këtë intensivisht po merren organet e rendit", ka thënë ajo. Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë të enjten në një konferencë për media, se ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, është në krye të aktiviteteve për t'u siguruar që sistemi (sistemi informativ i menaxhimit të financave të Kosovës) është i mbrojtur.

## Mustafa: Ministrja Bajrami nuk është aty për t'u dorëzuar para hajdutëve. E ka përkrahjen time

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, përmes një shkrimi në llogarinë e vet në "Facebook", i ka dalë në krah ministres së Financave, Hykmete Bajramit, pas avullimit të dy milionë eurove nga Thesari i Shtetit. "E përkrah plotësisht ministren e Financave, Hykmete Bajrami, në betejën e saj kundër kriminelëve që vodhën mbi 2 milionë euro nga Thesari i shtetit. Shoh se dikush ka dëshirë dhe bën thirrje që ajo të japë dorëheqje, por ata duhet ta kuptojnë se ministrja Bajrami nuk është

aty për t'u dorëzuar para hajdutëve duke krijuar boshllëk për fshehjen e gjurmëve të vjedhjes së parasë publike, por për t'u ballafaquar me krimin dhe me hajdutët, ashtu siç po vepron me të drejtë ajo", ka shkruar Mustafa, duke theksuar se krimi, korrupsionin dhe plaçkitja e parasë publike ka adresë. "Ftoj të gjitha organet shtetërore të punojnë për zbardhjen e shpejtë të këtij rasti, që të kthehen paratë e vjedhura nga buxhetin shtetit dhe kriminelët të përgjigjen para ligjit", ka thënë lideri i LDK-së.

Hoti ka thënë se organet e rendit dhe të ligjit janë duke bërë punën e tyre. "Mashtroesit dhe keqpërdoruesit brenda sistemit publik, brenda institucioneve, nuk kanë për të pasur vend, do të dalin mbi sipërfaqe si minjtë kur t'u hyjë uji përfundi", ka deklaruar Hoti.

Për këtë vjedhje ka reaguar edhe opozita. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Hekuran Murati, në një konferencë për media të enjten, ka folur lidhur me vjedhjet e fundit nga Thesari i shtetit dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë. Ai ka thënë se vjedhja e dy milionëve në Thesar është rezultat i politikës kriminale të kastës së vjetër politike. "Një mendësi qeverisje e tillë si në të kaluarën ku rikthehen partitë e stërvjetruara të mendësisë së vjetruar është normale që persona të tillë të bëjnë veprime të tilla sepse dikush u ka garantuar se nuk do të ndëshkohen. Kemi një rikthim të situatës sikurse më herët kur është vjedhur në Dhomën e Dëshmitarëve e nuk është dënua askush, janë dhënë 53 milionë euro dhe nuk ka dhënë llogari askush, janë vjedhur avance në emër të udhëtimeve zyrtare në Ministrinë e Shëndetësisë e nuk është dënua askush", ka thënë Murati.

Ndërkaq sa i përket vjedhjes në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, ai ka thënë se kemi të bëjmë me një vjedhje

fizike në një objekt ku ruhet nga Policia e Kosovës. "Sot, po ashtu, e kishim edhe lajmin tjetër në rastin e vjedhjes në AUV. Nuk kemi të bëjmë vetëm me vjedhje elektronike e transaksione, por edhe me vjedhje fizike në një ndërtesë që ruhet nga Policia e Kosovës ku në katin e tretë vidhet thesari me peshë 300 kg. Kjo trimëri është shkaktuar nga veprimet që rikthejnë gjendjen kaotike dhe kriminale në vend duke filluar prej zhbërjes së procesit të vettingut dhe zhbërjes së Task-forcës antikorruption dhe ndërhyrjes në drejtësi", ka thënë Murati.

Ndërkaq Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka kërkuar dorëheqjen e ministres së Financave, Hykmete Bajrami, pas vjedhjes së 2 milionë eurove në Thesarin e shtetit. "Partia Demokratike e Kosovës me shqetësim ka marrë lajmin për vjedhjen e 2 milionë eurove nga Thesari i shtetit. Situata është edhe më e rëndë kur në këtë fazë tejet të ndjeshme janë bërë shkakime në tri institucione që luftojnë krimin dhe mbikëqyrin sektorin financiar të shtetit. Për t'u dhënë hapësirë hetimeve të pavarura e për t'iu shmangur ndërhyrjes politike, PDK-ja kërkon dorëheqjen e ministres Bajrami dhe fton organet e drejtësisë që ta hetojnë çdo individ që është përfshirë në këtë krim qeveritar", është thënë në reagimin e PDK-së.



Kosovës vazhdon t'i bëhet e padrejtë me procesin e liberalizimit të vizave

# LIBERALIZIMI I VIZAVE PRITET TË SHTYHET PËR VITIN TJETËR

Njohësit e integritimeve evropiane kanë paralajmëruar se vendimmarrja për liberalizim të vizave, sipas të gjitha gjasave, do të shtyhet për vitin tjetër. Demush Shasha dhe Arbëresha Loxha-

Stublla kanë bërë me dije për "Epokën e re" se është shumë vështirë të mendohet se këtë vit BE-ja mund të marrë ndonjë vendim për këtë proces. Sipas tyre, BE-ja as në raportin e fundit për Kosovën nuk

jep ndonjë afat për këtë proces. Ata kanë vlerësuar se institucionet e Kosovës duhet të punojnë më shumë me vendet anëtare të BE-së të cilat janë skeptike për liberalizimin e vizave për Kosovën

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 22 TETOR** - Njohësit e integritimeve evropiane kanë shprehur skepticizëm se gjatë këtij viti mund të ndodhë vendimmarrja e BE-së për liberalizim të vizave për Kosovën. Ata kanë bërë me dije se ky proces, sipas të gjitha gjasave, do të shtyhet për vitin tjetër.

Drejtori ekzekutiv i Institutit EPIK, Demush Shasha, ka deklaruar për gazetën "Epoka e

re" se pritjet që deri në muajin dhjetor çështja e liberalizimit të vizave të trajtohet nga BE-ja. "Gjasat janë shumë të vogla. Ka mbetur edhe një takim i Këshillit të BE-së për Çështje të Brendshme dhe Drejtësi më 3-4 dhjetor 2020. Deri në muajin dhjetor çështja e liberalizimit të vizave do të trajtohet si prioritet brenda Këshillit të BE-së. Me gjasë, i gjithë procesi do të shtyhet për vitin 2021", ka thënë Shasha.

Ai ka bërë me dije se për këtë proces Kosova ka humbur shumë kohë për arsye tërësisht politike. "Ne kemi humbur momentumin pozitiv që ekzistonte në vitin 2016 për shkak të mungesës së konsensusit të spektrit politik lidhur me çështjen e demarkacionit i cili u ka kushtuar qytetarëve të Kosovës pothuajse pesë vjet izolim. Në vitin 2016 BE-ja i hapi derën Kosovës që të jetë pjesë e Zonës Shengen, por skena politike e Kosovës e refuzoi

këtë ofertë duke mbajtur kështu qytetarët e Kosovës të vetmit në Ballkanin Perëndimor pa të drejtën e lëvizjes së lirë. Ndërkohë, Kosova dështoi të ndërtojë një sistem të pavarur të drejtësisë i cili do të ishte në gjendje të shënojë përparim në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë" ka deklaruar ai. Shasha ka thënë se janë së paku katër faktorë të cilët janë duke penguar liberalizimin e vizave për Kosovën. Sipas tij, ata janë:

mungesa e rezultateve në kuadër të luftës kundër korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar, sfidat e shumta në fushën e sundimit të ligjit, ngecjet në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi dhe mungesa e vullnetit politik për liberalizim të vizave.

Edhe drejtoresha ekzekutive e Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Arbëresha Loxha-Stublla, ka deklaruar për

# Ministrja Haradinaj-Stublla paralajmëron vizitë në Izrael

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 TETOR - Komisioni për Integritet Evropian, kryesuar nga Ismet Beqiri, kryetar, ka mbajtur të enjten mbledhjen e radhës, në të cilën ka raportuar Meliza Haradinaj-Stublla, ministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Në fillim të takimit, kryetari i komisionit, Ismet Beqiri, pasi falënderoi ministrin për gatishmërinë e saj që të raportojë, si dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm të ministrisë me komisionin, bëri me dije se ky takim është në kuadër të fushëveprimtarisë dhe planit të punës së komisionit.

Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, para anëtarëve të komisionit ka paraqitur të arriturat dhe sfidat e ministrisë, duke vënë në pah se ndër angazhimet primare vazhdon të mbetet liberalizimi i vizave. Lidhur me këtë, ajo bëri me dije se shumica e shteteve të BE-së e vlerësojnë përmbushjen e kriterëve të vendosura nga ana e tyre e që ka të bëjë me këtë çështje por, tha ajo, skeptike në këtë drejtim vazhdojnë të mbesin shteti i Holandës dhe ai Francës.

Në vijim të raportimit të saj, ministrja foli edhe për angazhimet dhe qasjen konkrete ndaj shteteve që

ende hezitojnë ta mbështesin liberalizimin e vizave. Sa i përket integritit të Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë dhe BE, ministrja Haradinaj-Stublla ka thënë se shumica e vendeve anëtare e përkrahin integritin e plotë të Ballkanit Perëndimor në BE dhe në tërë mekanizmat e saj.

Ajo ka folur edhe për marrëveshjen e nënshkruar në Uashington, të cilën e ka vlerësuar shumë të rëndësishme, me theks të veçantë ka folur edhe për rëndësinë e njohjes së shtetësisë së Kosovës nga Izraeli. Me këtë rast, ministrja Haradinaj-Stublla para anëtarëve të komisionit ka bërë me dije se në një të

ardhme të afërt do të realizohet një vizitë zyrtare në Izrael ndërkaq, ka thënë ajo, pas nënshkrimit të marrëveshjes në Uashington, ka pasur zhvillime të përditshme në trekëndëshin ShBA, Izrael dhe Kosovë.

Pas kësaj anëtarët e komisionit ngritën një varg çështjesh dhe shtruan pyetje të shumta që kishin të bënin me procesin e integritetëve, për të cilat morën përgjigje nga ministrja. Në fund të kësaj mbledhjeje, komisioni përkrahu edhe Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2020-2024 si dhe planin e punës së komisionit për vitin 2020.



“Epokën e re” se BE-ja nuk jep ndonjë afat për këtë proces në raportin e fundit për Kosovën. “E vërtetë. Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2020 edhe një herë konfirmon që Kosova ka përmbushur kriteret minimale për liberalizimin e vizave dhe një gjë e tillë është konfirmuar edhe nga Parlamenti Evropian. Por i njëjti nuk jep një afat të caktuar se kur kjo mund të ndodhë ngaqë një gjë e tillë tashmë është në dorë të shteteve anëtare të BE-së”, është shprehur ajo.

Ajo ka bërë me dije se tani gjithçka është në duar të vendeve anëtare të BE-së. “Parlamenti Evropian ka konfirmuar dy herë radhazi se tashmë Kosova ka përmbushur kriteret e nevojshme për liberalizim dhe se BE-ja duhet ta gjejë mënyrën që shtetet anëtare unanimisht të procedojnë tutje dhe ta mbajnë premtimin e dhënë”, është shprehur ajo. Sipas drejtoreshës ekzekutive të GLPS-së, institucionet e Kosovës duhet të punojnë me vendet e BE-së që janë skeptike për këtë proces. “Kosova duhet të bëjë përpjekje që në bashkëpunim me vendet skeptike të gjejë mënyra për t’i adresuar brengat e tyre karshi Kosovës. Një mundësi ka qenë krijimi i grupeve që do t’i identifikonin dhe më pas adresonin problemet e identifikuar nga vendet të cilat janë kundër liberalizimit të

vizave për Kosovën. Deri më tani asgjë konkrete nuk është ndërmarrë në këtë drejtim”, ka deklaruar ajo.

Ndërsa analisti politik Faton Abdullahu ka kritikuar BE-në për mosliberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Ai ka vlerësuar se ky është një diskriminim anti-evropian që Brukseli po e bën kundër Kosovës evropiane. Sipas tij, vizat janë kthyer në një kartë politike kundër Kosovës për interesa të ndryshme klanore në BE-së. “Mosdhënia e vizave për qytetarët tanë është diskriminim anti-evropian që e bën Brukseli kundër Kosovës evropiane. Ka vetëm një arsye që e definon mirë dhe qartë këtë: fakti regresiv sepse vizat tanimë janë kthyer në kartë politike kundër Kosovës për interesa të ndryshme klanore në BE të cilat deshifrohen mirë edhe nëse kuptohet arsyeja pse tash së kohë kemi ftohjen e raporteve Uashington - Bruksel”, ka shkruar

ai, duke shtuar se zgjedhjet në ShBA mund ta ndryshojnë këtë raport. “Shpresoj shumë se zgjedhjet në Uashington do të determinojnë një raport më të mirë të ShBA-së me Brukselin e, për rrjedhojë, edhe një qasje të re e më kualitative të kësaj të fundit ndaj Kosovës, sidomos ndaj dialogut tonë me Serbinë”, është shprehur ai.

## As komisionari i BE-së nuk jep shpresë

As komisionari për Fqinjësi dhe Zgjerim i BE-së, Oliver Varhelyi, nuk ka dhënë ndonjë shpresë se liberalizimi i vizave për Kosovën mund të ndodhë së shpejti. Gjatë vizitës në Kosovë që pati para dy jave, ai ka thënë se Kosova duhet t’i bindë shtetet anëtare të BE-së për t’i liberalizuar vizat me Kosovën. Ai ka përsëritur se për Komisionin Evropian, Kosova i ka përmbushur kushtet në këtë

proces. “Vlerësimi ynë mbetet se i keni përmbushur të gjitha kushtet, por nuk mjafton vetëm vlerësimi ynë. Duhet t’i bindim shtetet anëtare”, ka thënë ai gjatë adresimit të tij para deputetëve të Kuvendit të Kosovës me rastin e vizitës së tij në Kosovë.

Gjatë vizitës ai vuri në pah se përkushtimi i BE-së për integritimin e vendit të Kosovës dhe të rajonit mbetet prioritet edhe në të ardhmen. Varhelyi ka theksuar se Bashkimi Evropian tani në fokus ka mbështetjen afatgjatë në rrafshin socio-ekonomik jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon. Ai ka thënë se përfaqësuesit e vendeve të Ballkanit Perëndimor duhet të punojnë për të arritur një marrëveshje për zhvillimin e tregut rajonal. “Kjo [marrëveshje] do ta shndërronë rajonin në një vend atraktiv për investitorët. Do të thotë është në interesin tonë strategjik ta sjellim Ballkanin Perëndimor më afër BE-së.

Ekziston një zbrazëti e madhe mes vendit tuaj, rajonit dhe BE-së. Aq më shpejt që e mbyllim këtë hapësirë, aq më shpejt fillojmë të krijojmë një ekonomi të qëndrueshme dhe të fuqishme”, është shprehur Varhelyi.

Udhëheqësit e Kosovës kohën e fundit e kanë kritikuar BE-në për këtë proces, duke thënë se padrejtësisht qytetarët e Kosovës po mbahen të izoluar. Më i zëshmi në këtë drejtim ka qenë presidenti i vendit, Hashim Thaçi. Ai edhe në konferencën e fundit për media ka theksuar se është duke ndodhur një padrejtësi nga ana e BE-së për qytetarët e Kosovës në këtë proces, duke shtuar se institucionet e Kosovës kanë zbatuar të gjitha kriteret që kërkohen për këtë proces. “Po ndodh një padrejtësi e madhe për qytetarët e Kosovës kur dihet se institucionet kanë zbatuar në tërësi kriteret për liberalizimin e vizave”, është shprehur Thaçi.

# BE-ja e shqetësuar për shuarjen e Task-Forcës Kundër Korrupsionit

PRISHTINË, 22 TETOR - Vendimi i Qeverisë së Kosovës, për shuarjen e Task-Forcës Speciale Kundër Korrupsionit, e cila ka funksionuar në kuadër të Policisë së Kosovës, ngrit shqetësime serioze rreth përkushtimit të Kosovës për ta luftuar korrupsionin, ka thënë zëdhënësjja e Komisionit Evropian, Ana Pisonero. Teksa është deklaruar për këtë çështje, ajo ka thënë se “kjo zyrë luan rol kyç në luftën kundër korrupsionit, siç është vlerësuar edhe në Raportin e Progresit dhe në raportin për monitorimin e drejtësisë të prezantuar nga misioni i BE-së për sundimin e ligjit (EULEX)”. “Qeveria sa më shpejt të jetë e mundur duhet ta sqarojë pozicionin e saj”, ka thënë kjo zëdhënëse e BE-së. Edhe diplomatët e shteteve

anëtare në Bruksel janë shprehur të habitur sesi menjëherë pas Raportit të Progresit, në të cilin pikërisht është kërkuar më shumë vullnet politik për ta luftuar korrupsionin, Kosova shuan një prej njësive që ka pasur rol në këtë drejtim.

Në Raportin e Progresit të miratuar para dy javësh thuhej se “Task-Forca Kundër Korrupsionit, që vepron si njësi speciale brenda Departamentit për Hetime në Policinë e Kosovës, heton dhe zbulon veprat e shkeljeve penale ekonomike, financiare si dhe të korrupsionit”. “Policia ishte e angazhuar në disa hetime të korrupsionit brenda institucioneve të Qeverisë së Kosovës dhe si rezultat i kësaj, disa raste të profilit të lartë janë paraqitur para



prokurorisë”, thuhej në Raportin e Progresit në pjesën ku flitej për rezultatet e luftës kundër korrupsionit. Aty përmendej se këto masa kishin sjellë edhe deri te aktakuzat ndaj dy gjykatësve

në dy rajone të ndryshme. “Gjatë periudhës së raportimit, numri i hetuesve financiarë që punonin në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit ishte rritur. Hetimet financiare duhet të

kryhen në mënyrë sistematike, të pavarur dhe paralelisht me procedurat penale për korrupsion dhe krim të organizuar” kishte konstatuar Komisioni Evropian në Raportin e Progresit.

## Qeveria do t’i ndajë edhe 2 milionë euro për komunitetet joshumicë



PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur në takim përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë, me të cilët ka diskutuar për planin e zbatimit dhe promovimin e programit për rimëkëmbje ekonomike, respektivisht për Masën 9-të, e cila lidhet në mënyrë specifike me këto komunitete. “Në bazë të Programit të miratuar në Qeveri, ne e kemi shpërndarë

një shumë prej 1.7 milionë eurosh si mbështetje për komunitetet joshumicë, ndërsa tani planifikojmë t’i shpërndajmë edhe 2 milionë euro për këto komunitete deri në fund të dhjetorit të këtij viti, në mënyrë që t’ua ofrojmë mbështetjen e duhur për përballimin e situatës së krijuar nga pandemia Covid-19”, ka thënë kryeministri Hoti. Po ashtu, kryeministri Hoti vlerësoi dhe kërkoi angazhimin

e të pranishmëve për shpërndarje të informacioneve dhe për identifikimin e rasteve, në mënyrë që ato raste të aplikojnë për të përfituar në kuadër të kësaj shume, të cilën qeveria e ka ndarë për ta. Përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë ndihmën e qeverisë Hoti e cilësuan si mbështetje më të madhe që ka ndodhur deri më tani, ndërsa bashkëpunimin tepër të shkëlqyeshëm dhe objektiv.

## Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, një ndër prioritet kryesorë të qeverisë

PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - **MINISTRI I MINISTRISË SË PUNËVE** të Brendshme, Agim Veliu, mori pjesë në Forumin Ministror ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor për punë të brendshme. Në këtë Forum u diskutua për shkëmbimin rajonal dhe përmirësimin e sistemeve të të dhënave si dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. Me këtë rast, ministri Veliu ka theksuar se nevojitet një bashkëpunim dhe bashkërendim më dinamik i aktiviteteve në fushën e migrimit të parregullt, në veçanti duke shkëmbyer të dhëna në kohë reale, e që do të reflektonte në parandalimin dhe luftimin e migrimit të

parregullt. Më tej ministri Veliu ka thënë se parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit është një ndër prioritet kryesorë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. “Ne jemi në fazën përfundimtare të procesit të bashkimit të Strategjive Nacionale për ekstremizmin e dhunshëm dhe të luftës kundër terrorizmit”, ka deklaruar Veliu. Në këtë takim ai ka theksuar se Republika e Kosovës ishte ndër shtetet e para që me ndihmën e partnerëve strategjikë realizoi rikthimin e organizuar të qytetarëve të Kosovës si pjesëtarët e organizatave terroriste ashtu edhe familjet e tyre.



## Edhe 159 raste të reja me Covid në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit ka regjistruar 159 raste të reja me Covid-19. Shifrat e reja dalin pas testimit të 1 245 mostrave, që përbën shifrën më të lartë të testeve të kryera brenda një dite në Kosovë, që prej fillimit të pandemisë. IKShPK-ja ka njoftuar se në 24-orëshin e fundit nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes me Covid-19



Prizren 5 raste, komuna Rahovec 5 raste, komuna Vushtrri 4 raste, komuna Obiliq 3 raste, komuna Skenderaj 3 raste, komuna Kamenicë 2 raste, komuna Lipjan 2 raste, komuna Viti 2 raste dhe me nga një rast komunat Drenas, Istog, Malishevë, Shtime dhe

Suharekë. Ndërkaq Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar se në klinikat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe në spitalet rajonale janë të shtrirë 222 pacientë, ku 137 prej tyre janë të konfirmuar me

koronavirus. Sipas raportit ditor të këtij shërbimi, 139 pacientë po trajtohen me oksigjenoterapi, një është në gjendje më të rëndë dhe është vendosur në respirator, ndërkaq 20 pacientë janë vendosur në makinën e frymëmarrjes së njohur me shkurtesën CPAP.

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 TETOR - Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 1 245 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 159 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes me

Covid-19.

Numri total i rasteve pozitive është 17 422 raste nga 83 923 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 657 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 58 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 14 894 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 1 871.

Rastet e fundit pozitive janë nga: komuna Prishtinë 54 raste, komuna Gjilan 34 raste, komuna Fushë Kosovë 11 raste, komuna Gjakovë 8 raste, komuna Pejë 8 raste, komuna Podujevë 7 raste, komuna Ferizaj 6 raste, komuna

## 1 500 specialistë i shtohen sistemit shëndetësor këtë vit

Nga dita e enjte sistemit shëndetësor në vendin tonë i janë shtuar edhe 1 500 specialistë. Me këtë rast, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se nga dita e parë si ministër ka pasur prioritet që të zgjidhet njëherë e përgjithmonë problemi i specialistëve. Ai ka thënë se në kategorinë e parë janë përfshirë profilet specialistike me prioritet nacional dhe specializimet e nevojshme në luftën kundër Covid-19

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 TETOR - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije të enjten se sistemit shëndetësor në Kosovë do t'i shtohen 1 500 specialistë. Ai ka thënë se ka qenë synim i tij që të zgjidhë atë që e ka konsideruar problem me specializime, proces "që i ka munguar Kosovës pothuajse për pesë vjet". "Faleminderit që sot jeni me ne në këtë ditë të rëndësishme për 1 500 specialistë të ardhshëm të shëndetësisë, akademikë të ardhshëm, për 1 500 familjet, shëndetësinë dhe vendin tonë. Nga sot sistemit shëndetësor i shtohen 1 500 specialistë. Nga dita e parë si ministër e kam pasur prioritet që të zgjidhet një herë e përgjithmonë problemi i specialistëve, që për vite të

tëra nuk janë angazhuar në profesionin e tyre për të cilin i kanë përfunduar studimet universitare. Tash ata do t'i ndjekin specializimet në fushat e preferuara të tyre. Falënderoj Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe kryeministrin Avdullah Hoti për përkrahjen dhe mirëkuptimin që ka pasur për mjekët e rinj, duke vendosur që së fundi edhe 400 mjekë të tjerë, t'i shtohen procesit të specializimit, me çka është rumbullakuar numri për 1 500 specializime", ka thënë Zemaj me këtë rast. Ai ka thënë se në kategorinë e parë janë përfshirë profilet specialistike me prioritet nacional dhe specializimet e nevojshme në luftën kundër Covid-19. "Specializantët e ardhshëm menjëherë do të kyçen në parandalimin dhe luftimin e virusit", ka thënë ai. Ministri Zemaj ka theksuar se

qindra mjekë të diplomuar prej vitesh e kanë pritur këtë vendim që t'u mundësohet ta ndjekin shkollimin specialistik. "Lajm tjetër i mirë është se Ministria e Shëndetësisë nga sivjet do të hapë konkurs për specializantë çdo vit, për të mos shkaktuar ngecje në sistem. Jemi të inkurajuar nga interesimi i madh

i mjekëve për t'u bërë pjesë e këtij konkursi, por jo të befasuar, duke marrë parasysh faktin se prej 4-5 vjetësh Ministria e Shëndetësisë nuk kishte shpallur konkurs për specializime, duke ua pamundësuar mjekëve një të drejtë të tyre, shkollimin specialistik dhe avancimin profesional", është shprehur

ministri Zemaj. Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, që ka qenë pjesë e konferencës për media, e ka konsideruar lajmin për nisje të specializimeve si "hapin më të madh në shëndetësi në katër-pesë vjetët e fundit, për t'i krijuar kapacitetet e nevojshme në institucione shëndetësore".

## Vjedhje në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë

PRISHTINË, 22 TETOR - Prokuroria Themelore në Prishtinë është njoftuar për një vjedhje që ka ndodhur të enjten në objektin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës (AUVK). Në këtë agjenci është

vjedhur një kasafortë. Në lidhje me rastin, Prokuroria Themelore në Prishtinë, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, është duke i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore për

ndriçimin e rrethanave dhe zbardhjes së plotë të rastit në fjalë.

Edhe Policia e Kosovës ka konfirmuar se më 22 tetor, në orën 08:05, është raportuar se në një objekt në Fushë-Kosovë

është kryer një vjedhje. "Njësitë kompetente policore kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe janë duke kryer hetime për rastin", ka njoftuar policia.

Zyrtarë të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë deri



më tani nuk janë prononcuar për rastin në fjalë.

## Hekurudha e re, me trena 120 km në orë

PRISHTINË, 22 TETOR - Ka disa muaj që kanë filluar punimet nga një kompani italiane për rehabilitimin e hekurudhës nga Hani i Elezit deri në kufi me Serbinë, në fshatin Leshak. Rehabilitimi i linjës hekurudhore, e gjatë 150 kilometra, po bëhet me donacione nga Bashkimi Evropian si dhe me kredi. Banorët që jetojnë afër hekurudhave kanë kërkuar masa më të rrepta të sigurisë kur të fillojnë të qarkullojnë trenat me shpejtësi deri 120 kilometra në orë, raporton "Rel".

Xhevat Ramosaj, u. d. i kryeshefit ekzekutiv në "Infrakos", ka thënë se hekurudha do të jetë plotësisht moderne. Gjithashtu, sipas tij, edhe sistemi i informimit do të jetë modern. "Do të jetë plotësisht

kompatibil me standardet e BE-së, për këtë arsye bëhet modernizimi që në 30-40 vjetët e ardhshme të mos ketë problem, do të thotë sa i përket kësaj linje hekurudhore", ka thënë ai.

Ramosaj ka treguar se do të jetë një linjë tërësisht e re sa i përket binarëve, shtresës së poshtme dhe asaj të epërme, pajisjeve sinjalizuese dhe atyre të telekomunikimit.

Gëzim Qerimi nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave të Kosovës thotë se modernizimi i hekurudhës dhe shpejtësia me të cilën do të lëvizin trenat në të ardhmen e afërt do ta bëjnë atraktiv për qytetarët këtë transport. Sipas tij, kjo hekurudhë do të ketë ndikim të madh në ekonominë e Kosovës për shkak të transportit të udhëtarëve dhe të mallrave.

Kosova ka rreth 330 kilometra



hekurudhë por, përveç asaj në drejtim të Pejës dhe Hanit të Elezit, linjat e tjera hekurudhore janë të dëmtuara

dhe nuk janë fare funksionale. Në ato pjesë ku lëvizin trenat nuk ka fare rrethoja si dhe mungojnë laurat në shumicën

e vendkalimeve. Rreth 20 aksidente, ku janë të përfshirë trenat, ndodhin çdo vit në Kosovë.

## KEDS Academy VIII hap dyert për studentët dhe nxënësit

PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Nga dita e enjte KEDS-i ka hapur dyert për avancimin profesional të gjeneratës së tetë të studentëve dhe nxënësve të Kosovës.

Pjesë e KEDS Academy VIII mund të bëhet secili nga studentët e vitit të fundit të studimeve në drejtimet e përzgjedhura dhe nxënësit e shkollave të mesme teknike-profesionale (viti i fundit), përmes aplikimit. Pra, pjesë e saj mund të jenë inxhinierët, ekonomistët, juristët, shkencëtarët apo gjeodetët e ardhshëm, sikurse nxënësit që dalin nga shkollat profesionale. "Qëllimi i



programit është të krijohen liderë të së nesërme. Aty, gjatë një viti, pjesëmarrësve iu ofrohen njohuritë më të avancuara në aspektin teorik.

Pastaj vjen pjesa praktike, ku pjesëmarrësit janë në kontakt me menaxhimin, operimin dhe hallkat e sistemit energjetik. Kjo gjeneratë do të

pranojë 30 studentët dhe 40 nxënësit më të vlerësuar në bazë të kriterëve të parapara. Për studentët do të jetë programi i lidershit, ndërsa për nxënës programi teknik", është thënë në njoftimin e KEDS-it.

Pjesëtarët e KEDS Academy përfitojnë njohuri dhe shkathtësi për integrim më të lehtë në tregun e punës si dhe për zhvillim të vazhdueshëm profesional.

Akademia është një mundësi e shkëlqyeshme për përfitimin e përvojave dhe ekspertizës vendore dhe ndërkombëtare sikurse mundësi për t'u inkuadruar

në tregun vendor dhe ndërkombëtar.

KEDS Academy ka filluar gjeneratën e parë disa muaj pas nisjes së operimeve nga vetë KEDS-i, pra në vitin 2013. Ky program ka fituar disa çmime ndërkombëtare në qendra të rëndësishme botërore si në Nju-Jork, Paris dhe Stamboll. Ky program është ndjekur si shembull edhe nga kompani të tjera. Deri tash pjesë e këtij programi kanë qenë mbi 350 nxënës e studentë të Kosovës, duke përfituar avancim të madh profesional. Një pjesë e konsiderueshme e tyre sot punojnë në KEDS.

## Ministri Reçica takoi përfaqësuesit e FSP "ElektroKosova"

PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka pritur të enjten në takim përfaqësuesit e Federatës Sindikale të Pavarur (FSP) "ElektroKosova", prirë nga kryetari Ahmet Hyseni, me të cilin është biseduar rreth

sfidave të kësaj sindikate e cila përfaqëson rreth 1 500 punëtorë të KEDS-KESCO. Nga përfaqësuesit e kësaj sindikate ministri Reçica kërkoi që të jenë sa më të zëshëm rreth mbrojtjes së të drejtave dhe përmirësimit të kushteve të punës për të gjithë punëtorët që janë nën

ombrellën e kësaj sindikate.

Reçica ka thënë se do të jenë gjithnjë një krah i fortë i punëtorëve dhe punëdhënësve, si dhe të pakompromis ndaj gjithë atyre që nuk respektojnë masat e rëndësishme që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës.





# MTI-ja lansoi databazën për tregtinë në shërbime

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 22 TETOR - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), me mbështetjen e qeverisë gjermane nëpërmjet GIZ Kosova, ka lansuar databazën për tregtinë në shërbime. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, në ceremoninë e lansimit ka thënë se sektori i shërbimeve është segmenti më i rëndësishëm që kontribuon në punësim. "Sektori i shërbimeve është segmenti më i madh i ekonomisë së Kosovës dhe forca shtytëse, që kontribuon në pjesën më të madhe, në

vlerën e shtuar, në punësim dhe në tregtinë vendore, kështu që veprimtaritë e shërbimeve kanë mbuluar 74 për qind të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2019 dhe ka punësuar 85 për qind të forcës së përgjithshme të punëtorëve në Kosovë. Gjithashtu, eksporti i tregtisë në shërbime për vitin 2019 ka arritur vlerën 1.6 miliard euro", ka theksuar ministri Krasniqi. Ai ka potencuar se qëllimi kryesor i kësaj baze të të dhënave është ta lehtësojë qasjen për të gjitha palët e interesit në kornizën ligjore, që rregullojnë aktivitetet e shërbimeve në Kosovë, duke ndihmuar kështu në operimin e

atyre që tanimë janë në treg dhe të atyre sipërmarrësve që duan të fillojnë të ofrojnë shërbime në Kosovë.

Duke e vlerësuar platformën elektronike për shërbime në tregti, ministri Krasniqi tha se kjo platformë është vetëm një hap i suksesshëm drejt themelimit të pikës së vetme të kontaktit, në bazë të direktivës së shërbimeve të Komisionit Evropian dhe Ligjit të Shërbimeve.

Ricardo Serri, nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, ka theksuar se është mirë që në këtë projekt të punohet bashkë, pasi është pjesë e partneritetit në mes tyre. "Kemi prekur disa

prej çështjeve kryesore, të cilat edhe unë do të doja t'i përsëris dhe t'i theksoj në këtë ditë të rëndësishme për ne, sepse është dita që lansohet ky projekt, pika kontaktuese për shërbime", është shprehur Serri, duke shtuar se kjo është diçka për të cilën është mirë të punojmë në këtë projekt së bashku me partnerët e tjerë. Ndërsa Mark Barret, udhëheqës i projektit që mbështet procesin e Integritimit në BE në kuadër të GIZ-Kosova, ka thënë se përmes këtij projekti dëshmohej se zbatimi i MSA-së është shumë praktik dhe rrugë e sigurt drejt integritimit në BE. "Ne kemi zbatuar në emër të qeverisë

gjermane. Edhe në këto rrethana pandeminë ia kemi dalë që të përfshihemi në disa aktivitete që kanë të bëjnë me procesin e integritimit. Mendoj se zhvillimi i kësaj pike tregon sesi procesi i integritimit me MSA është shumë praktik", ka thënë Barret.

Ai ka shtuar se ka shumë diskutime dhe ajo që zbatohet nëpërmjet këtij procesi bëhet shumë reale dhe ka të bëjë me përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe se është diçka që ndihmon në rrugëtimin e Kosovës përpara. Sipas Barret, krijimi i kësaj pike kontaktuese është hapi i parë drejt integritimit.



## Ndërprerjet e lidhjeve telefonike dhe mosnjohja e kodeve të internetit, faktorë dëmtues të bizneseve në Kosovë

PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Problemet e telefonisë mobile, kualiteti i dobët i shërbimeve të telefonive mobile, problemet me mbulimin e rrjetit 3G dhe 4G në autostradë dhe problemet me IP që po dëmtojnë miliona euro biznesin dhe buxhetin e Kosovës, ishin disa prej çështjeve të diskutimit në takim ndërmjet përfaqësuesve të Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK) me anëtarët e bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Përfaqësuesit e OAK-ut fillimisht theksuan se

problem kryesor është ndërprerja e lidhjeve telefonike si pasoja të kalimit nga një antenë në antenën tjetër si dhe kualiteti i dobët i telefonatave dhe shërbimeve të internetit 3G dhe 4G në pjesët e autostradave. Gjithashtu, sipas tyre, në çdo portal që ka të paraqitura reklama në fund të faqes, dhe në bazë të IP-ve shfaqen dhe reklammat, ku shpeshherë shfaqen reklama në gjuhë të tjera dhe jo në shqip. Po ashtu, përfaqësuesit e OAK-ut kanë thënë se kjo po ndikon negativisht te mediat, duke pësuar humbje financiare në biznes, njëkohësisht humbje

në buxhetin e shtetit. Ata kanë kërkuar që ARKEP të kontribuojë në eliminimin e këtyre problemeve.

Ndërkaq anëtarët e bordit të ARKEP-it përgëzuan përfaqësuesit e OAK-së për iniciativën e adresimit të problemeve të bizneseve nëpër institucione, duke theksuar se janë të hapur të mirëpresin çdo ankesë dhe çështje që ka të bëjë me shërbimet e telefonisë dhe postave. Gjithashtu, sa iu përket çështjeve të ngritura nga OAK-u, ata theksuan se Kosova nuk ka kod të internetit dhe të gjithë operatorët kycjen e gjejnë te



shtetet e tjera dhe kjo është arsyeja që Kosova nuk ka IP të njohur duke pasur parasysh

se duhet të jemi anëtarë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

## U përurua ndriçimi publik në Drenoc, investim i KFOR-it dhe Komunës së Malishevës



**MALISHEVË, 22 TETOR (ER)** - Në fshatin Drenoc, përkatësisht në rrugën "Asllan Laci", është përuruar rregullimi i ndriçimit publik, investim i përbashkët i Komunës së Malishevës dhe KFOR-it, përkatësisht Komandës së Regjionit të Perëndimit.

Në ceremoninë e përurimit

morën pjesë kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe komandanti i Komandës së Regjionit të Perëndimit të KFOR-it, kolonel Gianluca Figus. "Ky projekt është me shumë rëndësi për ne, pasi ndihmon në lëvizjen e lirë gjatë natës dhe në sigurinë e qytetarëve në këtë pjesë dhe

KFOR-i na ka ndihmuar në zgjerimin e rrjetit të ndriçimit në vendbanimin më të madh në Malishevë", ka thënë kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, duke e falënderuar KFOR-in italian për këtë mbështetje dhe për përkrahjen e vazhdueshme për Malishevën.

Ndërsa komandanti i Komandës Regjionale të Perëndimit të KFOR-it, koloneli Gianluca Figus, tha se "ky projekt ka rëndësi të madhe për dy arsye, e para sepse është bërë në bashkëpunim me komunën dhe e dyta sepse fshati i ngjanë shumë me vendin prej nga

vjen". Ai më pas e falënderoi kryetarin Begaj për bashkëpunimin e mirë dhe tha se bashkëpunimi do të vazhdojë me Malishevën. Përndryshe në këtë rrugë, apo në këtë pjesë të fshatit Drenoc, janë vendosur 50 drita, ku 25 drita i ka investuar KFOR-i dhe 25 drita Komuna e Malishevës.

## Bahtiri inspektion punimet në projektet që po realizohen përgjatë lumit Ibër



**MITROVICË, 22 TETOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, së bashku me drejtorin për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Besnik Beka, kanë inspektuar punimet të cilat janë duke u zhvilluar për rregullimin e shtratit të lumit "Ibër", si dhe për realizimin e projektit të ujërave të zeza. Me këtë rast, kryetari Bahtiri është shprehur mjaft i kënaqur me dinamikën e punimeve që

po kryhen në rregullimin e shtratit të lumit Ibër si dhe në ndërtimin e kanalizimeve pjesë e projektit të impiantit për menaxhim të ujërave të zeza, duke potencuar se janë ndër projektet më madhore dhe më të rëndësishme për qytetin e Mitrovicës.

Projekti për rregullimin e shtratit të lumit "Ibër", përveç murit mbrojtës i cili është duke u ndërtuar, do ta ketë edhe shtegun për

këmbësorë, hapësira gjelbërimi, ndriçim publik, ura kaluese apo pragun kapërderdhës, që do të jetë atraksion i vërtetë turistik dhe do të ofroj edhe mundësi të tjera rekreacioni jo vetëm për qytetarët e Mitrovicës, por edhe të tërë Kosovës. Këto projekte janë duke u realizuar si bashkëfinansim në mes të Komunës së Mitrovicës si dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

## Drejt finalizimit projekti i rregullimit dhe zgjerimit të shtratit të lumit Llap në qytet

**PODUJEVË, 22 TETOR (ER)** - Nën kryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, bashkë me drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Faik Muçiqi, inspektuan punimet për rregullimin dhe zgjerimin e shtratit të lumit Llap në qytet. Nën kryetari Rudari ka thënë se rregullimi dhe zgjerimi i

lumit Llap në qytet po shkon drejt finalizimit dhe deri në fund të vitit do të arrijnë tek ura në rrugën magjistrale. Pranë brigjeve të lumit po ndërtohet edhe shtegu për këmbësorë. Ky projekt do të finalizohet në tërësi me vendosjen e ndriçimit publik dhe mbjelljen e drurëve dekorativë.



# Kosova e gjunjëzuar në kërkim lëmoshe nga BE-ja

*Përvojat e Maqedonisë së Veriut me Greqinë dhe Bullgarinë në rrugën e saj për anëtarësim në BE dëshmojnë për problemet e mëdha që Kosova do t'i ketë kur Serbia do të anëtarësohet dhe ta përdorë veton e saj, nëse do të ketë marrëveshje kompromisi në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja. E përvojat e klasës politike në Kosovë dëshmojnë se anëtarët e institucioneve të Kosovës, pas krejt rezistencave deklarative ndaj presioneve dhe premtimeve, në fund vetë nënshkruajnë dhe vetë votojnë edhe në dem të vet Kosovës, në emër të Kosovës dhe të qytetarëve të saj shqiptarë.*



Shkruan Ekrem  
KRASNIQI, Bruksel

**S**hembulli i Maqedonisë së Veriut, me rregullat e tashme për zgjerimin e Bashkimit Evropian, përkatësisht për pranimin e shteteve në gjirin e saj me pajtimin e krejt vendeve anëtare, është dëshmi e përkryer se sa i komplikuar dhe i vështirë është procesi për ato vende që kanë mospajtime me vendet anëtare të bllokut evropian. Maqedonia e Veriut ka aplikuar për anëtarësim në BE në vitin 2004 dhe e ka marrë statusin e vendit kandidat në vitin 2005.

Fuqia e vetos e vendeve anëtare për të bllokuar gjithçka për vendet aspiruese është dëshmuar në mënyrën më të vrazhdë në rastin e Maqedonisë së Veriut e cila nga Greqia u detyrua që të ndërrojë emrin kushtetues. Edhe 15 vite më vonë, vendi fqinj i Kosovës ende nuk po mund t'i hapë bisedimet e anëtarësimit në BE.

Tash, është Bullgaria ajo e cila po e bllokoi për shkak të, kryesisht, gjuhës maqedonase të cilën bullgarët nuk e njohin si të tillë.

Nuk dihet edhe sa kohë do të kalojnë deri sa qeveria në Shkup do të detyrohet për t'u gjunjëzuar, ashtu siç u gjunjëzua nga Greqia për

çështjen e emrit. Fuqia e vetos e vendeve anëtare nuk ka ndonjë gjasë që të zhduket nga trakti i tashëm i BE-së, e as nga NATO.

Përvojat e Maqedonisë së Veriut me Greqinë për BE dhe NATO, dëshmojnë se me të njëjtat bllokada do të ballafaqohet edhe Kosova në rrugën e saj të premtuar për hyrje në BE, nëse ajo do të arrijë të ketë marrëveshje me njohje reciproke me Serbinë.

Në kuadër të kësaj marrëveshje, Kosovës po i kërkohet që të bëjë kompromise të mëdha në çështjet e brendshme të saj. E kamufluara autonomi për dhjetë komunat serbe me emrin Asociacioni i Komunave Serbe (ASM) është goditja e parë e rëndë mbi supet e Kosovës në rrugën e premtuar për në BE. Por, kur qytetarëve të Kosovës dhe politikanëve të tyre do t'u thuhet se me këso lloj kompromisesh, pos se do të ketë njohje nga Serbia, do t'u hiqen edhe vizat dhe se do të mund të vijin edhe njohjet nga pesë shtetet e BE-së, e katër prej tyre të NATO-s, dyshimet lindin nëse do të ketë rezistencë institucionale në Kosovë ndaj zbatimit të ASM-së.

Përvojat e deritashme, thonë se përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, me

premtime dhe nën presione dorëzohen dhe nënshkruajnë dhe votojnë të kundërtën e asaj që flasin.

Por, të njëjtit politikanë, por edhe një pjesë e qytetarëve të Kosovës, do të duhej të mësojnë nga përvoja e hidhur e Maqedonisë së Veriut me Greqinë dhe Bullgarinë, se çka i pret ata dhe Kosovën, nëse do ta pranojnë krijimin e autonomisë serbe, përkatësisht Republikës së dytë serbe në Ballkan, nën krejt presionet dhe premtimet nga kryeqendrat e mëdha të BE-së.

Në një skenar të këfillë, Serbia me këtë marrëveshje eventuale, do të anëtarësohej pas 4 apo 5 vitesh në BE, e Kosova do të gjendej e gjunjëzuar me të dy këmbët në situatën e Maqedonisë së Veriut dikur me Greqinë e tash me Bullgarinë.

Ajo së pari do të presë dhe shpresojë në njohjet nga Qipro, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja. Do të kalojnë vite deri sa do të arriheshin këto njohje, sepse institucionet e Kosovës nuk kanë asnjë plan dhe kërkesë konkrete se si duhet që të garantohen këto njohje para se të nënshkruhet ndonjë marrëveshje kompromisi me Serbinë.

Por, po supozojmë se këto

njohje do të vijin një ditë... Serbia kur të anëtarësohet në BE, do të ketë si edhe krejt shtetet e tjera të BE-së të drejtën e fuqisë së vetos për të bllokuar Kosovën për gjithçka dhe çfarëdo që t'i teket.

E tash merreni me mend, se cilat do të ishin kushtëzimet që Serbia do t'ia bënte Kosovës që ajo të marrë statusin e kandidatit, pastaj të çelë bisedimet, të hapë apo të mbyllë ndonjë bllok kapitujsh të bisedimeve...

Me fuqinë e vetos brenda BE-së, Serbia do të luajë me Kosovën si macja me miun deri sa të dërmojë plotësisht atë dhe ta gjunjëzojë qytetarët dhe politikanët e tyre për kompromise të reja për të njëjtën ASM dhe për të drejta të saj shtesë brenda Kosovës, në emër të të drejtave shtesë për pakicën serbe.

Kosova, qytetarët e saj dhe politikanët e tyre tashmë ua kanë dërguar porosinë krejt vendeve perëndimore se ata u dorëzohen presioneve dhe premtimeve për kompromise në dem të vet vendit dhe shtetit të tyre.

Kosova, dhe një pjesë e qytetarëve të saj, janë shndërruar në lypsa lëmoshe në raport me BE-në. Me një trend të këfillë të shndërrimit të vetvetes në rast humanitar që kërkon lëmoshë përditë

dhe pa ndonjë sinjal ndryshimi, Kosova edhe po trajtohet si e tillë tashmë e disa vite nga krejt vendet perëndimore dhe organizatat e tyre.

E kur në disa raste politikanët dhe qytetarët dijë t'i thonë "JO" BE-së, atëherë ata ndërrojnë fjalët dhe vënë nënshkrime pasi që e njëjta kërkesë u bëhet nga zyrtarët në Uashington. Pjesë të përmbajtjes së nënshkrimit të 4 shtatorit është dëshmia më e fundit e këtij lloj trendi gjunjëzimi nga kjo klasë politike me ulëse në institucionet e Kosovës. Përvojat e njëjta në të kaluarën janë të shumta.

E vendet perëndimore tashmë e kanë kuptuar këtë gjunjëzim, prandaj qasjen ndaj Kosovës e kanë ndërtuar mbi këtë përvojë tashmë e sa vite. "Vetë e keni nënshkruar", dinë të na thonë diplomatët dhe zyrtarët perëndimorë për gjykatën selektive speciale për krime të luftës. "Vetë e keni nënshkruar", dinë të na thonë diplomat e BE-së në Bruksel për kufirin me Malin e Zi. "Vetë e keni nënshkruar" po na thonë përsëri tash për nënshkrimet për ASM-në në 2013 dhe 2015. "Vetë e keni nënshkruar", do të na thonë edhe për nënshkrimet e tjera në pritje në radhë.


## Nis asfaltimi i rrugës Junik-Prejlep-Dranoc

**JUNIK, 22 TETOR (ER)** - Ka filluar asfaltimi i rrugës që lidh Junikun me Komunën e Deçanit, aneksi rrugor përmes fshatit Drenoc, projekt që ofron infrastrukturë të mirë rrugore dhe qasje të lehtë për qytetarët, duke krijuar infrastrukturë për bashkëpunim dhe zhvillim

ndërkomunal.

Projekti rrugor "Asfaltimi i rrugës Junik-Prejlep-Dranoc" bashkëfinancohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Komuna e Junikut. Projekti është duke u realizuar në kuadër të iniciativës "Shërbime të mira për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik".





INTERVISTË ME HISTORIANIN, FILOZOFIN DHE POETIN BOSHNJAK – IZET SARAJLIQ (1930-2002)

# VENDET MË TË KËQIJA PËR POEZI JANË VENDET KU MUND TË GJENDEN POEZITË!

**Intervistoi: Jasmina SOPOVA**  
(UNESCO Courier, prill 1998)  
Përktheu nga anglishtja:  
Alban TUFA

Poezia ka qenë pjesë e jetës suaj për një gjysmë shekulli. Si e shihni këtë formë arti sot? Më vjen keq kur shoh si poezia e ka humbur vendin që duhet të zë në jetën e njerëzve. Poetët janë pjesërisht përgjegjës për këtë, por gjithashtu duhet të fajësohet edhe fryma e epokës. Kur isha i ri, Neruda, Sartre-i, Malraux-i, Camus-i, Twain-i, Frost-i dhe Ungaretti ishin shkrimtarë të rëndësishëm. Të jetuarit në atë kohë sollin përgjegjësi dhe kënaqësi; duhet të tejkalohet vetja. Imagjino të kesh një poemë të botuar në një revistë pranë Neruda-s! Nuk përballohet ky mediokritet. Në botën letrare të sotme, nuk është e vështirë ta quash veten poet. Poeti së shpejti do t'i përkasë një specie të zhdukur. Kam frikë se njerëzit përfundimisht do të ndalen së lexuari.

## A jeni po aq pesimist për të ardhmen e prozës?

Po, sepse mendoj se romancierët modernë nuk mund të kujdesen më shumë për atë gjë thelbësore të njohur si dashuria. Nuk e mbaj mend heroin e fundit me të cilin u dashurova. Moshë e Ana Kareninës është zhdukur për mirë. Romancierët e sotëm shkruajnë kundrejt një sfondi dhune dhe duan të tronditin lexuesit e tyre. Në romanet moderne ekziston një lloj indiference, një dëshitim për të krijuar lidhje me lexuesit, shkaqet e të cilin nuk mund t'i kuptoj. Pas tragjedisë së Sarajevës, kisha mundësinë të bëja disa udhëtime jashtë vendit. U habita tek shihja vepra të shkëlqyera të lidhura me aq shumë njerëz që shfaqeshin në dritaret e librarive. Ka qark shumë bestsellerë dhe kaq pak shkrimtarë të mëdhenj. Epoka e artit të madh ka mbaruar. Duket sikur e kemi humbur shijimin e krijimit.

Një poet rus dikur thoshte se edhe trishtimi është i lumtur në poezinë tuaj. Por, poezitë e fundit të luftës japin përshtypjen e

kundërt.

Është fakt se të gjitha vlerat janë kthyer me kokë teposhtë, jo vetëm për mua, por për të gjithë. Të gjitha monumentet e vjetra janë zhbërë. Imoraliteti së shpejti do të zëvendësojë vlerat morale dhe gënjeshtret do të zëvendësojnë të vërtetën. Ky ndryshim ka ndodhur shumë shpejt. Nëse bota do të kishte lëvizur më ngadalë në këtë drejtim (që në të vërtetë çon në një fund të vdekur), njerëzit do të kenë patur kohë për t'u përgatitur psikologjikisht. Por, kjo është e pamundur për shkak të shpejtësisë me të cilën gjërat po lëvizin.

Mendoj se qytetërimi mori një kthim të gabuar rreth tridhjetë vjet më parë, por kompetencat na kanë vënë në një drejtim në të cilin nuk mund të shoh asnjë të ardhme. Më vjen keq dhe më bën depresiv fakti që konfuzioni absolut është pranuar si gjendje normale njerëzore.

## A e ndryshoi lufta pikëpamjen tuaj për botën?

Deri diku, po. Gjithmonë kam

menduar se njerëzimi ka nevojë për politikanë përgjegjës dhe se ka patur gjithnjë e më pak nga këto. Nuk është rastësi tek lufta që ka shkatërruar ish-atdheun tim; duhet të kishte ndodhur në një moment historik, kur nuk kishte më asnjë njeri të aftë për të dhënë një kthesë konstruktive ndaj ngjarjeve politike dhe duke udhëhequr këtë botë të varfër, aq të pasur në gjëra të vogla dhe aq të dobëta në bazat e saj, në shekullin e njëzet e një.

Kur të huajt erdhën në Sarajevë gjatë luftës, më pyetën se çfarë mendoja për qëndrimin e Perëndimit ndaj Bosnjës. Iu thash se ndërsa Tito kishte guxim t'i qëndronte fuqisë së Stalinit, askush sot – as Shtetet e Bashkuara, as Franca e as Gjermania – nuk janë në gjendje t'i thonë "jo" një kriminel lokal. Lufta më mësoi diçka tjetër. Më tregoi se sjellja e mendimtarëve të botës nuk është vetëm e papërgjegjshme, por edhe e pamoralshme. Kështu ishte edhe sjellja e disa prej gjeneralëve të vendosur në Bosnjë dhe Hercegovinë. Po mendoj një prej

tyre në veçanti, që është raportuar se ka dhunuar vajzat e reja myslimane të cilat i janë çuar atij në shtëpitë publike. Të gjithë e dinin këtë. Të gjithë u kthyen në qorra.

Lufta gjithashtu më tregoi kuptimin e solidaritetit. Ne morëm mbështetje të madhe nga njerëzit e zakonshëm, veçanërisht në Francë, Itali dhe Zvicër, dhe pa ata nuk do të kishim mbijetuar. Mendoja që zvicranët ishin njerëz që nuk i shfaqin ndjenjat e tyre. E pra, ishte Zvicra që na tregoi më shumë dashamirësi se kushdo tjetër.

## Jeta kulturore në Sarajevë ishte mjaft dinamike, apo jo? Jeta muzikore, teatri dhe botimi i gjithçkaje vazhdoi...

Shprehja latine thotë se njerëzit heshtin kur zhurma e armëve është e rreme. Një punë shumë e mirë u prodhua në Sarajevë gjatë luftës. Do të ishte mirë nëse të huajt do mund të lexonin disa nga gjërat që shkruam, në mënyrë që të kuptojnë se lufta civile është një murtajë, se është ngjitëse dhe se

mund të ndodhë diku tjetër në botë, në një formë edhe më të tmerrshme.

**Në një nga librat tuaj, "Recueil de guerre", thoni: Nëse unë kam mbijetuar, mbi gjithë këtë, falënderoj poezinë dhe një grup të njerëzve, popullin e zakonshëm, shenjtorët e vërtetë të Sarajevës, të cilët vështirë t'i njihja para luftës.**

I kam shkruar dy librat e mi gjatë luftës në bodrumin tim, ndërsa predhat zhurmonin mbi kokë. Nuk mundem, si Eluard-i, të pikturoj fjalën "liri" në muret e Sarajevës, sepse asnjë mur nuk mbeti në këmbë. Kështu i thashë gruas sime: "Më shih, jam si një Milton në fund të shekullit të njëzetë, duke shkruar nën dritën e qirinjë".

Por, nuk e nisa me idenë se do të shkruaja poezi. Nuk më interesonte ajo. Ishte një kohë e gjatë që kur s'kisha interes për poezinë. Pak para luftës, shkrova se vendet më të këqija për poezi ishin vendet ku mund të gjendeshin poezitë.

Kur thashë se poezia më kishte shpëtuar, doja të thosha se këto vite jashtëzakonisht të pakënaqshme të luftës, ishin ndoshta vitet më të mira të jetës sime si poet. Unë kam qenë i motivuar, kam pasur lexues, ose më mirë dëgjues. Nuk kishim asnjë letër për shtyp dhe nuk isha në marrëdhënie të ngushta me disa botues që ekzistonin. Sidoqoftë, ata ishin të specializuar në një punë pseudo-fetare dhe propaganduese, prandaj nuk isha shumë e interesuar që të botoheshin nga ata. Sidoqoftë, poezitë e mia arritën në publik, gjë që më bëri shumë të lumtur. Gjatë

luftës, gjendja ime letrare dhe morale në sytë e bashkëqytetarëve të mi nuk dukej e lartë dhe pashë se donin të më ndihmonin në një mënyrë apo në një tjetër. Ata largoheshin për mua edhe nga radha e ujit, edhe pse natyrisht kurrë nuk përfitova nga kjo. Ata më jepnin cigare, ose ndonjë mollë për nipin tim.

**Në këto rrethana, poezia bëhet diçka e ndryshme, apo jo?**

Kur një burrë ka një qese salcë, kur ai ka mjaft për të ngrënë, kur ai mund të dalë jashtë në ballkonin e tij, të hajë qershi ose të pijë kafe e cigare (dhe nuk është ai që duhet të lutej për këto), atëherë mund të mendojë për estetikën dhe estetizmin. Por, kur ai është i rrethuar nga mjerimi dhe është pre e tij, kur e gjen veten plotësisht të izoluar dhe të degraduar, ai pyet veten: "Ku janë fjalët e thjeshta, normale? A e kanë braktisur artin?" Unë kam pasur një portret të një prej poetëve të mi të preferuar: Boris Pasternak, në dhomën time të gjumit për një kohë të gjatë. Për mua, ajo ishte një relike. Është ende atje, pavarësisht miliona predhave që thuhet se kanë rënë në qytet. Një ditë, kur ndodhesha në dhomën time dhe jo poshtë në bodrum, e pashë dhe papritur mendova se edhe ai, Pasternak-u i mrekullueshëm, nuk do të thotë më për mua atë që ai thoshte dikur. Pra, shumë fjalë të bukura, një harmoni e tillë e përsosur, por asgjë për vuajtjen time, asgjë për vuajtjet njerëzore.

**A e ka ndryshuar lufta poezinë tuaj?**

Nuk mendoj se ka ndonjë ndryshim thelbësor midis asaj që

kam shkruar para dhe gjatë luftës. Forma mund të ndryshojë disi këtu dhe atje. Kur predhat po shpërthejnë rreth teje, duhet të zbresësh sa më shpejt që të mundesh, kështu që nuk i kushton shumë vëmendje formës. Sidoqoftë, kur ke diçka për të thënë, forma zgjedh veten. Unë nuk jam lloji i shkrimtarit që kërkon një poezi. Një poet nuk duhet ta bëjë këtë. Një poezi duhet të kërkojë (dhe ta gjejë) poetin e saj.

Nuk kam ndryshuar dhe nuk kam ndjerë ndonjë nevojë për ta bërë. Në vitin 1942, fashistët italianë vranë vëllanë tim të madh. Në çdo gjë që kam bërë prej nga ajo kohë, e kam patur të vështirë të mos e tradhtoj kujtimin e atij të riu. Tashti jam mbi pesëdhjetë vjet më i vjetër se im vëlla atëherë. Ai është personi për të cilin kam përgjegjësi

Në epokën e sotme super-ideologjike, e cila i hedh poshtë të gjitha ideologjitë e mëparshme, unë qëndroj në pozicionin që zgjodha në fund të asaj që tani e quajmë luftën "tjetër", 1939-1945. Kjo ishte një kohë kur të gjithë besonim se dashuria mund të ringjallej dhe menduam se kishim për të shkruar, sikur po mbjellim një fidan peme në parkun komunal ose sikur riparojmë bravën në derë. Ne të gjithë ishim në favor të dashurisë dhe qëndruam besnikë ndaj saj, përveç atyre që e tradhtuan gjatë kësaj lufte të fundit.

**A mendoni se një idealizëm i tillë është i mundur edhe sot?**

Nuk e di. Nuk mund të mendoj në këtë kohë se si veprova kur

isha i ri. Nuk jam më në gjendje të jem aq bujar sa më parë. Mendimet "universale" janë larg mendjes sime, dhe këto ditë, pragu i derës është kufiri që më ndan me botën. Jam i shqetësuar për shëndetin e gruas, për punën e vajzës, për të ardhmen e nipit. Jam i etur për të ripërtërirë fatin tim dhe për të rregulluar dhomën time. Nëse shkruaj një poezi ose dy, mirë, por nëse jo, nuk prish punë. Ndoshta kam shkruar mjaftueshëm.

**Në një program televiziv francez flisni për Sarajevën dhe familjen dhe tregoni se një pjesë e fatit tuaj ishte vrarë seriozisht.**

Një ditë, çetnikët e bombarduan banesën time tri herë. Ata mendonin se më kishin vrarë, kështu që pushuan së bombarduar dhe ikën. Mora një goditje në kokë dhe u rrëzova. Kur erdha në vete, përjetova diç qesharake. Një pikturë më kishte rënë përsipër dhe u zgjova me kokën në kornizë.

**Unë ju kam njohur që kur isha fëmijë, por kurrë nuk ju kam pyetur për fenë tuaj.**

Unë jam mysliman. Edhe çfarë? Kurrë nuk kam jetuar në një mjedis kryesisht fetar më shumë se çdo bashkatdhetar i imi. Nuk mund t'i shoh njerëzit si ortodoksë, myslimanë apo çfarëdo. Feja mund të jetë e rëndësishme për disa, por kjo është çështje personale.


Isha në Strasburg, jo shumë kohë më parë, nuk mund ta kuptoja se përse të gjithë silleshin rreth faktit që isha mysliman. Më thanë se ishte e rëndësishme të thuhej kështu. Nuk e


konsiderova aspak të rëndësishme. Në të njëjtën mënyrë, gazetarët e huaj që erdhën në Sarajevë shpesh më pyesnin nëse mendoja se të gjitha këto grupe etnike mund të jetonin së bashku. Gjithmonë u përgjigja duke ua prezantuar familjen time dhe duke iu thënë: "Gruaja ime është katolike, familja e saj erdhi nga Austria dhe vajza jonë u martua me një të ortodoks. Unë shpresoj që pas pesëmbëdhjetësh, kur im nip, Vladimiri të përjetojë të njëjtat vuajtje si Wertheri i ri i Goethe-s, ai do t'a vendosë dorën mbi supin e një çifuti. Kjo do të përfundonte portretin e familjes".

**A mendoni se Bosnja ka ndonjë të ardhme duke parë situatën aktuale?**

Nuk e di. Ashtu si shumë njerëz, me të drejtë apo pa të drejtë, i mbështes marrëveshjet e Dejtonit. Megjithatë, e di që nuk janë zgjidhja e vërtetë. Njerëzit që po vendosin për fatin e Bosnjës nuk e kanë prekur shpirtin e vendit, por flasin me gënjeshtër mahnitëse rreth korridoreve, republikave, federatave e kështu me radhë. Ka një gjë që Perëndimi nuk e kupton, ose nuk dëshiron. Në Spanjë pamë një shfaqje për fashizmin perëndimor, dhe në Bosnje pamë të njëjtën gjë për fashizmin e Evropës Lindore. Ndërsa në Spanjë fashizmi erdhi në pushtet – për fat të keq – Bosnja nuk e bëri. Por, nuk ka dëshmi se ai sistem ka dështuar përfundimisht. Çdo gjë është e mundur në ditët e sotme.

/Gazeta "Mapo"/





**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

# Gashi: Seria pozitive e Ballkanit nuk ndalet

Kushtrim Gashi ka shprehur optimizëm se skuadra e Ballkanit do ta vazhdojë serinë fantastike të rezultateve edhe në ndeshjet vijuese. “Kemi pasur një ecuri shumë të mirë në këto shtatë ndeshje dhe kemi punuar shumë që të kemi vazhdimësi të rezultateve pozitive edhe në ndeshjet e radhës, ku kemi lojtarë shumë cilësorë dhe secili mund ta zëvendësojë tjetrin”, ka thënë Gashi

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 22 TETOR - Mesfushori Kushtrim Gashi një ditë pas fitores që Ballkani e arriti ndaj Dritës (2-0), ka thënë për “Epokën e re” se kundërshtari si skuadër kampione në fuqi nuk ka treguar aq shumë në përballjen e zhvilluar të mërkurën në Suharekë, pasi në asnjë çast nuk ka arritur ta rrezikojë skuadrën lidere të Superligës. “Drita si kampione nuk tregoj shumë, ndërsa për ne ishte një ndeshje si të gjitha ndeshjet e tjera që i qasemi shumë seriozisht dhe në këtë ndeshje shënuam gol herët dhe e menaxhuam ndeshjen shumë mirë, duke mos lejuar të rrezikohemi për asnjë çast”, ka deklaruar Gashi.

Skuadra e Ballkanit edhe në edicionin e kaluar kishte një ecuri fantastike, por pas rikthimit të futbollit nga pushimi i detyrueshëm nga pandemia Covid-19, bëri disa gabime dhe e humbi garën për titull dhe kupë. Kjo skuadër po tregon formë fantastike edhe në këtë kampionat, ku në shtatë ndeshjet e zhvilluara deri tash, ka regjistruar gjashtë fitore dhe një barazim, kurse është e vetmja skuadër pa humbje në elitë. Lidhur me formën e skuadrës, Gashi ka shprehur optimizëm se suharekasit do të vazhdojnë të jetë të fortë edhe në ndeshjet e radhës për faktin se janë mirë të përgatitur fizikisht dhe kanë fond të madh me futbollistë cilësorë. “Kemi pasur një ecuri shumë të mirë në këto shtatë ndeshje dhe kemi punuar shumë që të kemi vazhdimësi të rezultateve pozitive edhe në ndeshjet e radhës, ku kemi lojtarë shumë cilësorë dhe cilido mund ta zëvendësojë tjetrin. Kampionati është i gjatë dhe shumë i rëndësishëm, kurse për ne më e rëndësishmja është ndeshja e radhës”, ka thënë Gashi.

Skuadra e drejtuar nga Ismet Munishi,



pas shtatë xhirove të zhvilluara, zë pozitën e parë me 19 pikë, e dyta është Prishtina me 11 pikë, por me një ndeshje më pak të zhvilluar.

## SHKURT

### Kosova dhe Shqipëria pësojnë rënie në renditjen e FIFA-s

Dy barazimet në Ligën e Kombeve, ndaj Lituanisë dhe Kazakistanit, kanë bërë që Shqipëria të zbresë në tri vende në renditjen e FIFA-s. Kombëtarja kuqezi ka zbritur në vendin e 69 me 1351 pikë, nga vendi i 66 ku ishte më parë. Rënie në klasifikim ka pësuar edhe Kosova, e cila ka kaluar nga vendi i 116 në vendin e 117. Kjo vjen për shkak të dy humbjeve ndaj Maqedonisë së Veriut dhe Sllovenisë dhe barazimit ndaj Greqisë. Për sa iu përket pozicioneve të para në renditje, Belgjika vazhdon të kryesojë, e ndjekur nga Franca në vendin e dytë dhe Brazili në vendin e tretë.

### KFF Mitrovica mëson kundërshtarin në Ligë e Kampionëve

Është tërhequr shorti për raundin e parë të Ligës së Kampionëve në kategorinë e femrave. Në këtë raund do të jenë pjesëmarrëse 40 skuadra, në mesin e tyre edhe kampionia e Kosovës, KFF Mitrovica. Në raundin e parë, KFF Mitrovica do të takohet me St. Polten Frauen nga Austria. Ndeshjet e para të raundit kualifikues luhen më 3 dhe 4 nëntor.

### Berisha rezulton pozitiv me Covid-19

Skuadra italiane SPAL-it ka njoftuar se ka bërë testin për koronavirusin dhe midis disa të të infektuarve ka dalë edhe portieri shqiptar Etrit Berisha. Megjithatë, klubi ka vendosur të bëjë një rikontrollim me tamponë për të gjithë grupin. Berisha nuk ka luajtur në sfidën e fundit kundër Empolit, por është parë në tribunë, i fokusuar nga mediat. Dhe fakti që ai është shfaqur në tribunë të martën në mbrëmje, e përjashton mundësinë që portieri i Kombëtares të ketë rezultuar pozitiv duke bërë që ai pritet të jetë titullar në ndeshjet e radhës së SPAL-it.

## Trepça '89: Jemi dëmtuar në dy ndeshje

MITROVICË, 22 TETOR (ER) - Skuadra e Trepçës '89 është e pakënaqur me ndarjen e drejtësisë. Klubi nga Mitrovica nëpërmjet një reagimi është ankuar se gjyqtarët e dëmtuan në dy ndeshje. Kundër Besës (2-1) dhe ndaj Gjilanit (0-0). “Qysh

në fillim të kampionatit në fazën e parë kampionale nga shtatë xhiro të luajtura janë anuluar dy gola plotësisht të rregullt. Ndaj Besës së Pejës në minutën e 91-t ku është barazuar rezultati me gol të rregullt, por gjyqtarëve nuk

menduan kështu dhe nga ajo ndeshje Besa ka dalë me pikë të plota, por rezultati është dashur të jetë i barabartë. Ne nuk reaguam dhe nuk u ankuam rreth asaj ndeshje. Kundër SC Gjilanit ndeshja përfundoi baras, por në

minutën e 87-t na u anulua goli i rregull dhe na u mohuan pikët e plota”, thuhet në reagimin e 89-shit. KF Trepça '89 kërkon përfundimin e këtyre marrëzive të padrejta në futboll, pasi nuk është rruga e duhur për të ecur përpara.



## Pensionohen profesorët Sadik Krasniqi dhe Aziz Dujaka

PRISHTINË, 22 TETOR - Të enjten janë pensionuar dy profesorët e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, prof. dr. Sadik Krasniqi dhe prof. asoc. dr.

Aziz Dujaka. Dekani i FEFS-së, Musa Selimi, ka vlerësuar lart kontributin e profesorëve Krasniqi dhe Dujaka ndër gjenerata. "Profesorët e

nderuar prof. dr. Sadik Krasniqi dhe prof. asoc. dr. Aziz Dujaka u dekoruan me rastin e daljes në pension! Faleminderit për punën e

shkëlqyeshme dhe kontributin e madh ndër gjenerata!", ka shkruar Selimi në profilin e vet në "Facebook".



## Veteranët e Ferizajt, të suksesshëm në turneun e Antalisë

FERIZAJ, 22 TETOR (ER) - KF Ferizaj - Veteranët ishin pjesëmarrës në turneun e dhjetë i cili mbahet dy herë në vit në Side të Antalisë. Sivjet turneu u zhvillua nga data 14 deri më 18 tetor dhe morën pjesë 28 ekipe nga shumë vende të ndryshme të botës, si Turqia, Rumania, Moldavia, Qipro (Turke) dhe Kosova me tri ekipe (Ferizajn, Prizrenin dhe Lumbardhin). KF Ferizaj - Veteranët ishte në grupin C së bashku me ekipet turke si Karaman Masterler, Bursa Adalet, dhe Dirbakir.

Në tri ndeshje veteranët e ferizajas shënuan fitore. Në xhiron e parë Ferizaj e mposhti Karamanin (1-3), në xhiron e dytë ferizajasit ishin bindës ndaj Bursës (3-0) dhe në xhiron e tretë Ferizaj arriti fitore edhe ndaj Diarbakire (1-2). "Klubi ynë ishte në pozitën e parë me pikë maksimale 9 pikë dhe kualifikohej për 1-8 e finales ku u takua me një ekip shumë të fuqishëm Turk Van Masterler. Ferizaj edhe në këtë takim doli



fitues pas një ndeshje fantastike me rezultat bindës 3-0. Ky takim u zhvillua në orën 11:00 dhe në temperatura shumë të larta ku lojtarët tanë shpenzuan shumë energji dhe takim i radhës në çerekfinale ishte po atë ditë nga ora 17:00 me një super ekip favorit për ta fituar turneun Denizli dhe pas një beteje titanike ekipi ynë humbi në kohën shtesë me rezultat 2-1, por paraqitja jonë ishte shumë e

mirë", ka thënë Bujar Asllani, lojtar dhe përfaqësues i ekipit. "Fitues i turneut të 10-të 'CUMHURIYET KUPASI' është ekipi i Irakut. Të gjithë lojtarët tanë i përgëzojmë për paraqitje shumë të mirë dhe të disiplinueshme, por Fitim Sadriu, Arsim Abazi, Fatos Ademi, Agron Istrefi, Përparim Veliu, Betim Qerkini dhe të gjithë të tjerët kanë luajtur me zemër", ka shtuar Asllani.

## LeBron: Sezonin tjetër, Lakersat më të fortë se këtë vit

LOS ANXHELOS, 22 TETOR - Skuadra e LA Lakersit u shpall kampione e NBA-së pas 10 vjetësh pritje, në një nga sezonet më të vështira të historisë si pasojë e pandemisë Covid-19. Por çfarë do të ndodhë sezonin e ri? A do të jenë sërish Lakers pretendent për titull? Ai që u jep përgjigje këtyre pyetjeve është LeBron Jamesi. "Ne jemi kampionët në fuqi dhe kemi për detyrë të qëndrojmë sa më shumë në majë. Nuk na mbetet gjë tjetër veçse sezonin e ri të jemi edhe më të fortë se këtë vit", ka thënë James.

LeBron dhe Anthony Davis u përzgjodhën në pesëshen titulluarë të këtij sezoni të NBA-së, një fakt ky që konfirmon për forcën e skuadrës kaliforniane, që kishte në radhët e saj dy nga yjet e kampionatit. "Merkato e këtij viti ofron shumë opsione interesante,



ndaj jam i sigurt se edhe Lakersat do t'i bëjnë lëvizjet e duhura", ka shtuar LeBron James, referuar faktit se Goran Dragiq e Serge Ibaka do të jenë lojtarë të lirë. Po ashtu, edhe mjaft basketbollistë të tjerë presin të lëvizin. "Kemi një ekip të mirë dhe nuk na mbetet gjë tjetër veçse të përforcohemi

edhe më shumë. Sezonin tjetër do të jetë më e vështirë, sidomos në Perëndim, pasi Clippers, Dallasi apo Golden State do të jenë ndryshe. Kjo konferencë është një bombë që mund të shpërthejë në çdo çast. Të fitosh një titull të dytë radhazi është gjithnjë më e vështirë", ka deklaruar Jamesi.

### SHKURT

#### Ronaldo sërish pozitiv me Covid-19

Ylli i Portugalisë, Cristiano Ronaldo, do t'i mungojë Juventusit në ndeshjen kundër Barcelonës në Ligën e Kampionëve, pasi ka rezultuar për herë të dytë pozitiv me koronavirus. 35-vjeçari është testuar prapë, por prapë ka dalë pozitiv, sipas mediave spanjolle. Ronaldo nuk do të takohet me rivalin e tij të La Liga-s, Lionel Messin.

#### Pezullohet kampionati i futbollit në Çeki

Pezullohet kampionati në Republikën Çeke. Ky është turneu i parë që ndalet përsëri për shkak të numrit të lartë të të infektuarve me koronavirus në ditët e fundit. Mirëpo ky vendim mund të ketë gjithashtu një ndikim në Ligën e Evropës te Sparta e Pragës, që është kundërshtarja e Milanit në fazën e grupeve. Në fakt, ekipi nga kryeqyteti i Çekisë ka marrë "ok" vetëm për ta pritur skuadrën franceze Lille në ndeshjen e parë në grupe. Për ndeshjet e ardhshme situata do të rivlerësohet dhe, nëse ka përkeqësim, mund të ketë tërheqje të kësaj skuadre nga turneu. Në stadium nuk do të ketë spektatorë, pas urdhrat të nxjerrë nga Ministria Çeke e Shëndetësisë, përveç 350 personave të angazhuar për mbarëvajtjen e takimit.

#### Mulleri pret ftesë nga Lowi

Thomas Muller beson se e ka dëshmuar veten dhe meriton ftesën nga Kombëtarja e Gjermanisë dhe se, pavarësisht çfarë ndodh, ai nuk do të ndalet. Mulleri së bashku me Hummels dhe Boateng nuk janë përfshirë nga tekniku Joachim Low në edicionin jo të mirë të Kupës së Botës në vitin 2018. Sulmuesi i Bayernit që nga ajo kohë nuk është paraqitur me kombëtaren, pasi që Low nuk ka qenë i kënaqur me të. Tekniku i Gjermanisë muajin e kaluar tha se ai është një lojtar i mrekullueshëm, por e ardhmja i përket gjeneratës së re. "Të gjithë mund ta shohin se në çfarë forme të mirë jam. Nuk kam nevojë të them asgjë më shumë. Do ta marr me ngadalë dhe tani do të shohim se çfarë do të ndodhë", ka thënë Mulleri.

#### Juve dhe PSG-ja në garë për Ramosin

Sergio Ramosi mund të largohet falas në fund të sezonit nga Real Madridi dhe kjo ka bërë që Juventusit dhe Paris Saint-Germaini të vihen pas tij. Kontrata aktuale e mbrojtësit me Real Madridin skadon vitin e ardhshëm dhe nuk ka indikacione për një rinovim. Kjo thuhet se ka lënë derën e hapur për klube të tjera që potencialisht ta joshin atë për sezonin e ardhshëm. Sipas gazetarit të njohur Fabrizio Romano, si Juventusit ashtu edhe Paris Saint-Germaini po mendojnë të përpiqen të nënshkruajnë me Ramosin në fund të sezonit. Thuhet se mbrojtësi spanjoll është i etur të mbetet aty ku është, por një ofertë e madhe nga Juventusit ose PSG-ja mund ta ndryshojë mendjen e lojtarit.

## Giggs: Cavani, supergoditje nga Unitedi

Edinson Cavani është goditja e madhe e Manchester Unitedit në merkato. "El Matador" është prej vitesh një ndër goleadorët më të mirë në planet dhe Ryan Giggs, trajneri i Uellsit dhe ish-lojtari i

njohur i klubit të Premierë Ligës ka thurur elozhe për 33-vjeçarin në një deklaratë për YouTube Webby & O'Neill. "Në ndeshjen time të dytë si trajner i Uellsit, u përballa me Uruguain dhe Cavani luajti në

atë sfidë. Mund të them se atë ditë ishte më mirë se Luis Suarez. Dua të tregohem i sinqertë, nuk e mendoja se ishte kaq futbollist i mirë. Cavani nuk luan ndeshje zyrtare prej muajsh, por Manchester

Unitedi ka gjetur saktësisht atë që i duhej dhe çfarë prisnin tifozët: një qendërsulmues, një bomber të vërtetë. Në ekip janë edhe Rashford e Martial, të cilët janë gjysmanësor dhe gjysmësulmues.

Ndërsa Cavani është një sulmuesi i vërtetë, ka përvojë, shpresoj të bëjë gjëra të mira tek United dhe t'i ndihmojë shokët e skuadrës për t'u përmirësuar. Njësoj siç ka bërë Bruno Fernandes", ka thënë Giggsi.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERSITÄT  
"HAXHI ZEKA"



Ref. Nr. Pejë, 15.10.2020

Në bazë të nenin 42, 47, 48, Rregullores për Procedurat Vlerësuese për Angazhimin e Bashkëpunësorëve të Jashtëm në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë nr. 2327/17, të dt. 02.10.2017 Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur më dt. 15.10.2020, vendosi që të shpall:

#### KONKURS

**Për angazhim të bashkëpunësorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njëjësive akademike të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, për vitin akademik 2020/21**

Angazhimi me honorar i bashkëpunësorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime do të behët në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Rregulloren në fuqi për të Ardhurat Personale të Personelit Akademik të UHZ-së, Rregulloren për Procedurat Vlerësuese për Angazhimin e Bashkëpunësorëve të Jashtëm në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë nr. 2327/17, të dt. 02.10.2017.

#### I. Kushtet e përgjithshme dhe procedura për angazhim

- Procedura e angazhimit bëhet në mënyrë transparente nëpërmjet shpalljes së konkursit publik sipas kushteve të përcaktuara me Rregulloren për Procedurat Vlerësuese për Angazhimin e Bashkëpunësorëve të Jashtëm në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë nr. 2327/17, të dt. 02.10.2017.
- Bashkëpunësoret e jashtëm mund të angazhohen në UHZ për një periudhë të caktuar kohore, më qellim të ofrimit të shërbimeve intelektuale për ligjërata dhe ushtrime mbi bazën e një konkursi publik, për pagesë me honorar. Angazhimi sipas këtij konkursi nuk nënkupton themelimin të marrëdhënies së rregullt të punës e as pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet.
- UHZ nuk mund të angazhojë në ligjërata përkatësisht ushtrime asnjë bashkëpunësor të jashtëm, i cili ka më tepër se një angazhim jashtë UHZ - së.

#### II. Fondi i orëve për bashkëpunësorët e jashtëm dhe profesorët vizitorë

- Bashkëpunësorët e jashtëm për ligjërata dhe profesorët vizitorë mund të mbajnë deri në 6 ore në javë.
- Bashkëpunësorët e jashtëm për ushtrime mund të mbajnë deri në 8 ore në javë.
- Në raste të mungesës së bashkëpunësorëve të jashtëm me gradën adekuate, në përputhje me Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunësorëve të jashtëm për ligjërata në nivelin bachelor mund të angazhohen edhe kandidatët me gradën e Magjistrisë (Mr. Sc.) ose Masterit (MA), nën mbikëqyrjen e profesorit me gradën Dr. Sc.
- Pagesa për kategorinë nga paragrafi 3 i këtij neni bëhet si për bashkëpunësorin për ushtrime.

#### III. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

- Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:
  - kërkesën me biografi;
  - certifikatën e lindjes (jo me te vjetër se 6 muaj);
  - kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar nga organi kompetent (kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë vendi, duhet të sjellin vendimin për nostrifikim-barasvlerën e diplomës përkatëse bachelor, master, magjistraturë, doktoratë);
  - kandidatët, të cilët konkurrojnë për pozitën e bashkëpunësorit për ushtrime, lektorit dhe korepetitorit duhet të sjellin edhe certifikatën e notave të studimeve bachelor dhe atyre master;
  - dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale, si dhe informatat e tjera specifike shtesë;
  - dëshmitë për angazhimet paraprake në UHZ ose në ndonjë Institucion të akredituar të arsimit të lartë;
  - dëshmia për njohjen e gjuhës angleze apo të ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për konkurruesit.
  - Dëshmi të organeve kompetente që nuk është nën hetime;
  - Aplikacionet e pakompletuara me dokumentet e kërkuara në këtë konkurs nuk do të merren parasysh.
  - Kandidatët që kanë kontratë të rregullt të punës në Universitetet Publike në Kosovë dhe jashtë Kosovës më të cilat UHZ-ja, ka të nënshkruar marrëveshje

bashkëpunimi për shkëmbim të personelit akademik, duhet të sjellin dokumentet si në vijim: **a)** Kërkesën me biografi (CV) duke specifikuar pozitën për të cilën aplikon dhe **b)** kopjen e vendimit për zgjedhjen e fundit që dëshmon thirrjen akademike pranë një institucioni publik të arsimit të lartë.

#### IV. Kohëzgjatja e kontratës për honorar dhe kompensimi

- Kandidatët të cilët do të përzgjidhen për angazhim me honorar në mësimdhënie dhe ushtrime, do të pajisen me kontrata për honorar varësisht prej fondit të orëve që posedojnë dhe kohëzgjatjes së angazhimit.
- Kompensimi do të bëhet sipas raportit të orëve të realizuara, të nxjerra nga sistemi elektronik gjatë semestrit të caktuar, i cili vërtetohet nga njësi akademike përkatëse, por jo më shumë se fondi i orëve të përcaktuara sipas Rregullores për të ardhurat personale të personelit akademik të UHZ - së.
- Të gjitha kontratat e përkohshme të angazhimit me honorar do të jenë të bazuara në dispozitat e Statutit UHZ - së, Rregullores në fuqi për të ardhurat personale të UHZ -së, Ligjin e Punës të Republikës së Kosovës nr. 03-L-212, përkatësisht dispozitave të nenit 8, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.2, paragrafit 4, 7 dhe 8, nenit 11 dhe nenit 14 të këtij ligji.

#### V. E drejta e ankesës

- Fakultetet obligohen që të themelojnë komision për shqyrtimin e ankesave dhe parashtrësive lidhur me angazhimin e bashkëpunësorëve të jashtëm.
- Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankesë pranë komisionit për ankesa në fakultetin përkatës, brenda 8 ditëve nga dita e marrjes së vendimit në këshill të fakultetit.
- Komisioni i ankesave më së largu 3 dite pas përfundimit të afatit të ankesave përpilon raportin dhe propozimin përkatës të njëjtën ditë e dorëzon në këshill të fakultetit. Këshilli i fakultetit në afat prej 3 ditëve nga marrja e raportit duhet ta shqyrtoj propozimin dhe të vendosë për miratim ose refuzim të tij.
- Ankesa duhet të bëhet më së largu 7 ditë nga dita e pranimit në dorëzim të vendimit të Senatit të UHZ - së më të cilin pala konsideron se i është mohuar e drejta për angazhim.
- Ankesa duhet të dorëzohet në fakultetin përkatës, të njëjtat më pas nga fakulteti përkatës dorëzohen në rektorat dhe shqyrtohen nga Komisioni i Senatit për ankesa dhe parashtrësia në afat prej 15 ditësh nga dita e mbylljes së afatit të ankimit. Ankesa duhet të jetë e qartë dhe konkrete, duhet të përfshijë të gjitha argumentet relevante dhe arsyeshmërinë e kontestimit të vendimit.
- Raporti i ankesave të shqyrtuara nga Komisioni i ankesave dhe parashtrësive do të propozohet për rishqyrtim dhe vendosje përfundimtare në nivel të Senatit të UHZ-së.
- Pala ankuese do të njoftohet me shkrim lidhur me vendimin e Senatit, si shkallë e fundit për çështje akademike në nivel të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.
- Kundër vendimit përfundimtar të Senatit, kandidati mund të drejtohen gjykatës kompetente.

**Vërejtje:** Angazhimi në pozitën e poshtëshënuara do të bëhet varësisht prej numrit të studentëve të regjistruar në vitin akademik 2020/21, gjithashtu edhe nga plotësimi i vendeve të lartcekura me staf të rregullt akademik. Kandidatët e përzgjedhur në raste të tilla do të informohen më kohë lidhur me angazhimin apo mos angazhimin, para fillimit të çdo semestri.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në kopje elektronike në [apliko.online@unhz.eu](mailto:apliko.online@unhz.eu)

Aplikacionet e arritura pas afatit, ato të pakompletuara si dhe ato që nuk deponohen të skanuara përmes postës elektronike në adresën e lartcekur, nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursi mbetet i hapur (pesë ditë) në <http://www.unhz.eu>, respektivisht prej datës 22.10.2020 deri me datën 26.10.2020

Konkursi shpallet sipas propozimeve të njëjësive akademike dhe atë si në vijim:

#### FAKULTETI I BIZNESIT

##### Bashkëpunësor të jashtëm për ushtrime:

- Dy bashkëpunësorë të jashtëm për ushtrime për lëndët: Biznesi Elektronik, Teknologji Informative;
- Dy bashkëpunësorë të jashtëm për ushtrime për lëndën: Matematikë;

#### FAKULTETI JURIDIK

##### Bashkëpunësor të jashtëm për ligjërata:



1. Tre bashkëpunëtorë të jashtëm për ligjërata në lëndët: Historia e Institucioneve Juridike Evropiane, E Drejta Romake, Qeverisje Lokale, Mendim Kritik, Sistemi Politik, Etika Ligjore Profesionale;
2. Dy bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndët: Sociologji e Së Drejtës, Sociologji-Arte;
3. Dy bashkëpunëtorë të jashtëm për ligjërata për grup lëndësh civile;
4. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata për grup lëndësh në lëmin penale;
5. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndën : Gjuhë angleze I dhe II;

**Bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime:**

1. Tre bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime për grup lëndësh administrative – kushtetuese;
2. Tre bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime për lëndët: Historia e Institucioneve Juridike Evropiane, E Drejta Romake, Sociologjia e Së Drejtës, Sociologji-Arte, Sociologji-MTHM;
3. Tre bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime për grup lëndësh ndërkombëtare dhe evropiane;
4. Dy bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime grup lëndësh civile;

**FAKULTETI I MENAXHIMIT NË TURIZËM, HOTELERI DHE MJEDIS****Bashkëpunëtor jashtëm për ligjërata në Drejtimet në Gjuhë Shqipe dhe Gjuhën Boshnjake:**

1. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata për lëndën: Gjuhë Angleze;

**Bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime:**

1. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndën: Matematikë;
- 2.
3. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndën: Gjuhë Angleze;
4. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët : Hyrje në Shkencat Mjedisore, Menaxhimi dhe Mbrojtja e Mjedisit, (Sem. Dim 4 orë) , E Drejta Mjedisore, Menaxhimi Mjedisor dhe Industria.( Sem. Ver 4 orë);

**FAKULTETI I AGROBIZNESIT****Bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata:**

1. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndët: Gjuhë Angleze &U ( TU, TPB, AA ) dhe në Arte;
2. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndët: Hidrologjia & Hidroteknik (A&A,S.II), Parimet dhe Praktika e Ujitjes, L & U ( AA );
3. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndët: Administrimi & Menaxhim Toke (A&A, S.V) L & U, Bazat e Pemëtarisë. (TPB ,S.IV) L & U.. Hyrje në Shkencë Toke U

**Bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime:**

1. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime në lëndët: Vlersmi i Pasojave në Mjedisë U, Bazat Testuese të Bimëve Bujqësore L &U;
2. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime në lëndët: Matematikë, ( TU, TPB, AA);
3. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime në lëndët: Bioteknologji Ushqimore, Teknologjia për Përpunimin e Maltit, Kontrolli & Sigurimi i Cilësisë në Industrinë Ushqimore;
4. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime në lëndët: Ekologjia I dhe II, Ekologjia Mjedisore;

**FAKULTETI I ARTEVE****Bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndët:**

1. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndët: Trumpet 5-6, Praktikë Pedagogjike 1-2, Teknika themelore në instrumentet frymore 1, Praktika Artistike 3;
2. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndën: Solokëndim 1-2;
3. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndën: Koorepetim 1 – 5 – 6 – 7 – 8;
4. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata në lëndën: Kitarë 1 – 2;



**MILLENNIUM  
FOUNDATION  
KOSOVO**

**SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE (SPN)**

Country	Kosovo
Project Name	Threshold Program
Procurement Title	Contract for the Construction of Household Efficiency Retrofits (HER)
Procurement Ref. Number	RFQ / 2020/No. 015
Type of Procurement (goods, works or services as applicable)	Works
Employer	Millennium Foundation of Kosovo (MFK)
Publication Date	23 October 2020
Submission Deadline	09 November 2020; 14:00 pm (Kosovo Time)

The Millennium Foundation Kosovo has received financing from the Millennium Challenge Corporation toward the cost of the “Threshold Program agreement”, and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for the Construction of Household Efficiency Retrofits (HER).

MCC’s funding is appropriated by the U.S. Congress and obligated to the threshold up-front, with no incremental or partial funding. So, when a contract is signed with an MCA Entity, money is already available to the MCA Entity and, for most contracts, invoices are paid directly to Contractors/Consultants/Suppliers by the US Treasury.

MFK now invites *password protected bids* from eligible *bidders* for the Works Requirements under IDIQ Contract relate to two specific tasks to be performed by the Contractor. One task is related to the site visit, detail measurements of building and preparation of sub-project Bill of Quantities (Service Order) and another task relates to the energy efficiency works to be provided on the specific household (Works Order).

Bidding will be conducted through the *Shopping* procedures as specified in the MCC Program Procurement Guidelines (PPG), and is open to all eligible bidders or consultants as defined in the PPG.

A complete set of Request for Request for Quotation (RFQ) documents including any clarifications, notices and/or addendums may be obtained by interested eligible bidders through the following website (Eventual clarifications or any changes to the RFQ document shall be published at the latest 3 days before the submission deadline on the link provided below):

<https://millenniumkosovo.org/procurement>

A pre-Bid conference shall take place at the 29 October 2020, at 14:00 am (Kosovo Time), through Zoom meeting link: <https://us02web.zoom.us/j/85692269759>

Bidders interested in submitting bids should register their interest by sending a completed registration, with the reference and subject of the RFQ to the Procurement manager at [procurement@millenniumkosovo.org](mailto:procurement@millenniumkosovo.org), giving full contact details of the bidder.

Please note that only electronic applications submitted via the File Request Link (dropbox link) shall be accepted. Submissions by hard copy or by email are not acceptable and shall culminate in bids rejection. The File link for submission of bids is included in the RFQ document.

Bids shall be submitted ONLY to the file request link provided in RFQ documents no later than 09 November 2020 at 14:00 (Kosovo Time). Only electronic submission will be permitted. Late applications will be rejected.

**Contact Information:**

The address(es) referred to above is (are):	Str. “Migjeni” no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Attn:	Arton Çitaku MFK Procurement Manager Str. “Migjeni” no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Tel:	00 383 38 752 110
E-mail:	<a href="mailto:procurement@millenniumkosovo.org">procurement@millenniumkosovo.org</a>
Website:	<a href="https://millenniumkosovo.org">https://millenniumkosovo.org</a>



**Kompania Rajonale e Ujësjesit**  
Regional Water Supply Company  
Regionalna vodovodna kompanija

**KOMPANIA RAJONALE E UJESJELLESIT KRU 'GJAKOVA' Sh.A.**  
–GJAKOVE Në mbështetje të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe autorizimeve të dhëna nga Bordi i Drejtorëve me rregulloren për marrjen dhe dhënien me qira të objekteve të KRU 'Gjakova' SH.A-Gjakove Shfrytëzimi i hapësirave do të bëhet me qëllim të trajtimit të drejtë, si dhe sigurimit të mundësive më të mira, për të krijuar te hyra, bazuar në rregulloret e brendshme dhe Ligjet në fuqi nxjerr këtë:

**Ftesë për ofertim për marrjen me qera të hapësirave për Pikat Arkëtuese për KRU "GJAKOVA" "sh.a-Gjakovë.**

**Kushtet e KRU'Gjakova" sh.a për marrjen e hapësirave me qera për pikat arkëtuese Gjakove, Rahovec.**

Dokumentacioni pronësoro-juridik urbanistik në rregull,

Nyje sanitare (banje, tualet),

Dysheme me pllaka, parket, ose laminat

Vendosje të grilave- parrakeve të sigurisë sipas kërkesës së komisionit

Ndriqim të mjaftueshem në përputhje me hapësirën e zyrës postare,

Pa obligime paraprake financiare ndaj Ujësjesit, KEDS dhe shërbimeve tjera komunale,

Njehsor të veqante të energjisë elektrike dhe të ujit (ujëmates),

Hapësirë e mjaftueshme në m2 për ushtrimin e veprimtarisë për pika të shitjes,

Kati përdhës i objektit,

Afati kohor i marrjes me qera në kohëzgjatje prej 1 vit me mundësi vazhdimi

### **KRITERET E KRU'Gjakova"sh.a-Gjakovë**

Të drejtë pjesëmarrje kanë si personat fizik dhe juridik.

Persona fizik duhet të kenë kopjen e letërnjoftimit, vërtetimin nga Gjykata që nuk janë në hetime

Personat juridik duhet të sjellin certifikatën e regjistrimit të biznesit kurse vërtetimi nga Gjykata në emër të Operatorit ekonomik se nuk është në hetime

### **INFORMATA ADMINISTRATIVE**

Komisioni themeluar nga KRU'Gjakova' sh.a., do të bëjë vlerësimin dhe përzgjedhjen e ofertës më të mirë dhe më të favorshme.

Obligimet tatimore me rastin e dhënies së parcelës me qera dhe marrjes së hapësirave me qera zbriten sipas Ligjeve në fuqi, Qiramarrësi zbret nga qiraja qdo ndalesë tatimore që kërkohet me Ligj në emër të qiradhënësit dhe qiramarrësit ja siguron qiradhënësit një certifikatë vjetore të ndalesave tatimore.

Ofertat duhet të dorëzohen të mbyllura.

Ofertuesit mund të vizitojnë parcelën qdo ditë pune prej orës 9.00.15.00

Afati për dorëzimin e ofertave: është deri me datën 06.11.2020 në ora 16:00.

Vendi i dorëzimit, arkiva e KRU'Gjakova sh.a. Gjakova rr. UÇK nr. 7 50000 Gjakove.nr tel 0390320503

### **>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► "Petarca" SH.P.K. shpall të humbur certifikatën e biznesit me nr. Identifikues 810055659.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar të salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkohet 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783



Bujar Salihu (1972) është nga Pogradja e Gjilanit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjilan. Në vitin 1990 filloi studimet në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Prishtinës por, për shkak të rrethanave politike, u detyrua t'i braktisë ato dhe Kosovën. Që nga viti 1992 jeton në Zvicër. Ka botuar përmbledhjet poetike: *Në xipat e vetmisë* (1994), *Më pak se jetë* (1997), *Skeleti i dallëndyshes* (2002). Poezitë e tij janë përfshirë në disa antologji dhe janë përkthyer në disa gjuhë. Është fitues i disa çmimeve letrare. *Linga e heshtjes* është libri i tij i katërt.

26 vjet më parë, në moshën 22 vjeçe, një libër me poezi e botoi në dy gjuhë, në shqip dhe në frëngjisht. Pas botimit të librit të parë më 1994, i botoi edhe dy të tjerë dhe, me disa autorë shqiptarë, foli në disa gjuhë pasi disa përgatitës hartuan antologji me poezi shqipe. Veçantitë e tij letrare i kemi vënë re qëmoti, por edhe i kanë zënë ngoje Ali Podrimja, Shaip Beqiri, Mustafë Xhemaili, Arif Molliqi, Faik Shkodra, Xhemail Ahmeti, Nexhat Rexha e ndonjë tjetër që tash s'po na kujtohet. Prandaj, duke pasur veçanti më tepër se disa poetë të tjerë e duke qenë poezia e tij objekt krahasimi me atë të A. Tufës, L. Leshanakut, A. Balës, B. Cufajt, V. Berishës, R. Zekthit, I. Belliut, D. Gashit, M. Mavrajt, Xh. Beqirit, L. Arapit, Rr. Paçarizit, E. Hatibit etj., disa poezi të Bujar Salihut i kemi botuar në revistën *Akademia*. Me kalimin e viteve, ai duke shtuar veçantitë gjuhësore dhe tematike në poezi e ne duke veneruar krijimet e tij, këtë herë i botojmë këtë libër, i cili një shok tjetër e ka të rrallë. Lexojini të gjitha poezitë e këtij libri, por mos harroni t'i lexoni dy herë poezitë *Dita jote e fundit*, *Buka*, *Eja të pajtohemi*, *Veshkat e vyshkura*, *Hija e qershisë*, *S'e mbajte premtimin*, *E përvaqshme*, *Puthje*, *Mbrëmë*, *Në vend të pasthënies* dhe t'i mësoni përmendësh sepse fjalët, fjalitë, figurat, temat dhe motivet e tyre ju duhen shumë në jetën e përditshme.


4<sup>99</sup>€



Sh. B. Armagedoni

Linga e heshtjes • Bujar Salihu

Bujar Salihu



LINGA E HESHTJES  
(poezi)



Arben Veselaj është gazetar dhe autor i disa librave letrarë. Ka mbaruar studimet themelore dhe ato postdiplomike për letërsi në Universitetin e Prishtinës. Punon redaktor për kulturë në Radiotelevizionin e Kosovës. Në periodikët letrarë dhe shkencorë shqiptarë ka publikuar kryesisht kritikë dhe studime letrare. Disa nga tregimet dhe esetë e tij janë përfshirë në antologji të ndryshme. Në vitin 2001 botoi librin me poezi *Shpërrallosje*, kurse në vitin 2017 studimin *Tema kadareane*. Më 2017, për zhanrin e kritikës dhe të eseistikës, u laureua nga Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës me Çmimin Vjetor për Letërsi.

Kur e kam lexuar dorëshkrimin *Triptikon arbëresh* të autorit Arben Veselaj më kanë ndodhur tri fenomene: 1. Disa herë më është dashur t'u kthehem disa faqeve përsëdyt, pasi më rrëmbente rrëfimi dhe shpesh nuk arrija të parashikoja asgjë - parashikimet më dilnin huq; 2. Jam kthyer në kohë dhe kam bashkëjetuar, para së gjithash, me De Radën e me Skiroin, pikërisht në sheshin e Shën Mitrit e të fshatrave të tjera arbëreshe të Kalabrisë e të Sicilisë; dhe 3. E kam lakmuar Arbenin që ka shkruar diçka që kam planifikuar së paku nja tri vjet. Një krijim që arrin me i shkakti këto kokëçarje e kënaqësi, unë e përjetoj si kryevepër. E, ky libër ka histori, letërsi, politikë, peizazh... kulmi është shlyerja e kufijve zhanrorë që Arben Veselaj arrin ta bëjë.

Dr. Rrahman Paçarizi


Qasja askematike dhe johistoriciste mbi gjenezën e letërsisë shqipe dhe qytetërimin modern shqiptar, e bën këtë vepër unike dhe me rëndësi në studimet e albanologjisë. Libri *Triptikon arbëresh* i gazetarit dhe studiuesit Arben Veselaj është një adresë e re me vlerë të veçantë për studiuesit dhe hulumtuesit e rinj, mbi shumë të panjohura që qëndrojnë të stivuara e të pluhurosura faqeve të historisë së qytetërimit shqiptar. Rrëfyer nga sfondi i një ekspedite personale prej një gazetari e studiuesi të letërsisë, ky libër përbën sintezën e historisë letrare, politike dhe fetare të botës arbëreshe. Thellësia studimore, kombinuar me artin e të rrëfyerit, herë si shtjellim letrar e herë si reportazh, e bën atë shumë të dobishëm edhe për studentët e gazetarisë. Një apoteozë e madhështisë arbëreshe që na mban frymën gjatë të lexuarit.

4<sup>99</sup>€



Dr. Arben Fetoshi

Triptikon arbëresh • Arben Veselaj



ARBEN VESELAJ

TRIPTIKON ARBËRESH

(historikja, estetikeja, ikonikja)

-  S. GIORGIO ALB. Mbuzati
-  VACCARIZZO ALB. Vakarici
-  S. COSMO ALB. Strighari
-  MACCHIA ALB. Maqi



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

